

PËRMBAJTJA E REVISTËS:

Numri XLV, viti 2008

Faqe

Nga veprimtaritë e QSP-së

Raport: Monitorimi i zbatimit të së drejtës së peticionit në Shqipëri. Nevoja për ndryshime dhe propozime ligjore

Qendra e Studimeve Parlamentare 4

Peticioni, sa ia vënë veshin?

Petro KOÇI 36

Raport: Monitorimi i financimit të fushatës zgjedhore dhe zbatimit të ligjit mbi transparencën e subjekteve zgjedhore gjatë zgjedhjeve parlamentare të vitit 2009

Qendra e Studimeve Parlamentare 40

TABLE OF CONTENTS:

45th issue, year 2008

| | Page |
|--|------|
| <i>From the CPS activities</i> | |
| Report: Monitoring the implementation of the petition right in Albania. Need for changes and legal amendments Centre for Parliamentary Studies | 4 |
| Petition, do they pay heed to? Petro KOÇI | 36 |
| Report: Monitoring the electoral campaign financing and implementation of the law on transparency during the parliamentary elections 2009 Centre for Parliamentary Studies | 40 |

Rubrikat në vijim synojnë prezantimin e politikave ligjore dhe të trajtimeve teorike për organizimin dhe funksionimin e institucioneve kushtetuese. Botuesi vlerëson si një kontribut në zhvillimin dhe përmirësimin e funksionimit të institucioneve kushtetuese, paraqitjen e opinioneve dhe të mendimeve të studiuesve të ndryshëm, në mënyrë të paanshme dhe objektive, duke nxitur një debat profesional.

Opinionet e paraqitura janë të autorëve dhe nuk përfaqësojnë qëndrimin e botuesit të kësaj reviste.

Raport: Monitorimi i zbatimit të së drejtës së petitionit në Shqipëri

Nevoja për ndryshime dhe propozime ligjore

Qendra e Studimeve Parlamentare

I. HYRJE

Peticionet janë një mënyrë shumë e mirë dhe efektive e shprehjes së protestës që mund t'u adresohen drejtpërdrejt zyrtarëve të lartë të shtetit dhe atyre vendorë. E drejta e qytetarëve për të përdorur petitionin si formë ankese dhe për t'u kërkuar institucioneve publike informacione, si dhe detyrimi i këtyre të fundit për t'iu përgjigjur në kohë dhe sipas parashikimeve në ligj janë një shprehje jetësore e funksionimit të demokracisë në një vend. Respektimi dhe përgjegjshmëria ndaj kësaj të drejte rrit pjesëmarrjen e njerëzve në jetën publike dhe siguron besimin e tyre për institucionet shtetërore.

Qytetarët ankohen se ata mund të mos marrin shërbimin që ata pretendojnë që duhet të kenë nga administrata publike. Jo vetëm kaq, por procedurat mund të jenë edhe shumë të lodhshme, të gjata dhe në rastin më të keq edhe korruptive. Pjesëmarrja e publikut nëpërmjet peticioneve dhe ankesave mund të jetë një mjet i dobishëm për të shmangur korrupsionin dhe shpërdorimet e zyrtarëve me detyrën.

Kështu, në një demokraci përfaqësuese, pjesëmarrja e publikut është guri themelor i këtij sistemi; ajo është parim bazë që lidh qeverinë me popullin. Ajo përligj sistemin dhe bën që qeveria të jetë e përgjegjshme. Në jetën tonë të përditshme rrallë herë mendojmë për vlerat e saj intelektuale, ligjore ose politike, të cilat, mes burimeve, na kthejnë në kohën e Aristotelit dhe të Magna

Kartës. Mes të tjerave, pjesëmarrja e publikut ndryshon nga mënyra se si të drejtat ligjore dhe procedurale janë parashikuar në ligjet e shtetit dhe se sa të efektshme kanë qenë ato në plotësimin e nevojave të njerëzve në të kaluarën, me qëllim që t'i hapin rrugën pjesëmarrjes së publikut në të ardhmen. Me këtë aksiomë në mendje, një sistem demokratik qeverisës vendos kuadrin e tij ligjor, duke ofruar kanale të efektshme komunikimi me qytetarët.

II. PETICIONI NË NJË VËSHTRIM HISTORIK

Koncepti aktual i peticionit i korrespondon asaj ç'ka është parashikuar shekuj më parë në Magna Carta, një prej dokumenteve të parë ligjorë hartuar në Mbretërinë e Anglisë në vitin 1215. Në Magna Carta (përkthimi në anglishten moderne), thuhet: “Nëse ne, kryegjyqtari ynë, nëpunësit tanë, ose ndonjë prej shërbëtorëve tanë kryen ndonjë shkelje kundrejt një personi ose shkel ndonjë prej neneve të qetësisë dhe sigurisë, dhe shkelja është bërë në dijeni të katër prej 25 baronëve, ata duhet të vijnë tek ne – ose në mungesë tonë te kryegjyqtari – të deklarojnë dhe të kërkojnë rivendosje të menjëhershme të të drejtës.” Me fjalë të tjera, edhe pse pushteti u ishte dhënë 25 baronëve të zgjedhur nga Mbreti, këta e kanë ende autoritetin të ngrenë peticion ndaj Mbretërisë, nëse ndiejnë se janë shkaktuar padrejtësi¹.

Më vonë, kjo e drejtë e peticionit u konfirmua edhe në Deklaratën Angleze të të Drejtave, e shkruar në vitin 1689, e cila thotë që kushdo mund të pretendojë peticion ndaj Mbretit pa pasur frikë për ndëshkim.

Në SHBA, e drejta e peticionit përbën një prej pesë lirive themelore të parashikuara në Kushtetutën e vitit 1789 (Amendamenti I).

Në vitin 1963 është përfshirë në nenet e Rregullores së Parlamentit Europian dhe për të ardhur më pas më 12 prill 1989 në marrëveshjen ndërinstytucionale midis Parlamentit Europian, Këshillit dhe Komisionit Europian, ku u konfirmua kjo e drejtë dhe u ofrua një garanci më shumë në

¹ Information paper: www.learningtogive.org

lidhje me ndjekjen e peticioneve në BE.

Në vitin 1992, Marrëveshja e Maastricht-it përfshiu të drejtën e peticionit midis shumë të drejtave të tjera njohur qytetarëve të BE-së.

III. REZULTATET E MONITORIMIT PËR ZBATIMIN E TË DREJTËS SË PETICIONIT NË INSTITUCIONET QENDRORE PUBLIKE

Metodologjia e përgatitur për procesin e monitorimit

Për realizimin e këtij raporti është përdorur një metodologji e caktuar e cila përfshin:

Hartimin e dy modele pyetësorësh për plotësim, një për institucionin e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë dhe një për institucionet e tjera të parashikuara në planin e monitorimit; mbledhjen dhe analizimin e rasteve studimore të peticioneve pranë institucioneve publike, vëzhgimin e legjislacionit në disa prej vendeve të BE-së.

- Pyetësi për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë u hartua specifikisht më vete në disa prej rubrikave të tij për vetë rolin e Kuvendit në trajtimin e peticioneve. Duke qenë se është i vetmi organ që ka të trajtuar veçmas në një akt ligjor trajtimin e peticioneve, u mendua që ky fakt të shikohej me kujdes për të parë më nga afër funksionimin dhe angazhimin e strukturave të këtij institucioni në trajtimin e peticioneve. Rubrikat specifike të pyetësorit për Kuvendin konsistojnë në çështje si: procesi i ndjekjes së peticionit që nga momenti i regjistrimit të tij, titulluar: Procedimi pas regjistrimit të peticionit dhe vlerësimi i praktikës së deritanishme, për të parë reagimin e këtij institucioni ndaj rasteve të peticioneve dhe përgjegjshmërinë e tij ndaj zbatimit të kësaj të drejte.

- Pyetësi për institucionet e tjera të parashikuara për monitorim synon mbledhjen e një informacioni të plotë, të saktë dhe konkret për zbatimin e së drejtës së peticionit nga qytetarët. Pyetësi është i organizuar në disa rubrika pyetjesh si: identifikimi i bazës ligjore të peticioneve; subjektet e dërgimit të

peticioneve; mënyra e paraqitjes dhe forma e peticionit; procedimi pas regjistrimit të peticionit dhe afatet; përmbajtja e peticionit dhe reagimi i institucionit; vlerësimi i praktikës së deritanishme.

- Marrja dhe analizimi i rasteve studimore u pa si një mënyrë e mirë në konkretizimin e vëzhgimit tonë dhe si një mënyrë për të parë angazhimin e institucioneve publike në zgjidhjen e problemeve objekt peticioni/kërkese. Ajo që u synua ishte gjetja e rasteve që kanë pasur një impakt të ndjeshëm në publik dhe në jetën qytetare.

- Një pasqyrë e legjislacionit të vendeve tjera të me qëllim afrimin e praktikave dhe përshtatjen e masave legjislative vendase me atë të vendeve të BE-së.

Raporti i monitorimit

Monitorimi i zbatimit të së drejtës së peticionit u shtri në shtatë institucione publike dhe u zhvillua në periudhën janar-maj 2009. Për mbledhjen e informacionit për vlerësimin lidhur me zbatimin e të drejtës së peticionit dhe procedura e ndjekur u shfrytëzuan këto burime: intervista në bazë të pyetësorëve; vëzhgime nga monitoruesi; konsultimi i dokumenteve dhe i faqeve të internetit aty ku ekzistonin, biseda të drejtpërdrejta me përfaqësues të institucioneve dhe organizatave, marrja dhe analizimi i rasteve konkrete të peticioneve.

Institucionet e monitoruara janë:

1. Kuvendi i Republikës së Shqipërisë
2. Presidenca
3. Këshilli i Ministrave (KM)
4. Ministria e Brendshme (MB)
5. Këshilli i Lartë i Drejtësisë (KLD)
6. Avokati i Popullit (AP)
7. Bashkia e Tiranës (BT)

Me miratimin e planit të monitorimit u mendua që në përzgjedhjen e

institucioneve të ishin të përfshira organe qendrore të pavarura, si Kuvendi dhe Presidenca, organe nga pushteti ekzekutiv si Këshilli i Ministrave e Ministria e Brendshme, organe përfaqësuese të pushtetit gjyqësor si Këshilli i Lartë i Drejtësisë, organe të pavarura të administratës publike si Avokati i Popullit dhe nga pushteti vendor u zgjodh Bashkia e Tiranës.

Rezultate të monitorimit

1. Ligje, akte nënligjore ose rregullore që rregullojnë marrjen dhe procedimin e peticionit nga publiku.

1.1 A ka ndonjë ligj ose akt nënligjor për organizimin dhe funksionimin e institucionit?

1.2 Nëse po, a është e rregulluar procedura e marrjes dhe procedimit administrativ të peticionit nga publiku? A janë këto rregulla të qarta për t'u zbatuar? A janë këto rregulla të plota?

1.3 Nëse procedura e marrjes dhe procedimit të peticionit nuk është rregulluar me ndonjë nga aktet e mësipërme, cilit akt(akte) ligjor e nënligjor i referoheni për procedimin administrativ të peticionit?

1.4 A ka dallim në trajtimin e ankesës administrative nga peticioni dhe nëse po, ku qëndron ky dallim?

1.1. Institucionet që kanë një ligj për organizimin dhe funksionimin e tyre të brendshëm janë: Avokati i Popullit dhe Këshilli i Lartë i Drejtësisë. Të gjitha të tjerat funksionojnë në bazë të ligjit për informimin mbi dokumente zyrtare, të Kodit të Procedurave Administrative dhe rregulloreve të tyre të brendshme.

1.2. Kuvendi, Presidenca, Ministria e Brendshme, Këshilli i Lartë i Drejtësisë dhe Avokati i Popullit e kanë të rregulluar me rregulloret e brendshme procesin e marrjes dhe të trajtimit të peticioneve dhe ankesave të publikut.

Institucionet, që e mbështetin këtë veprimtari te rregullorja e brendshme,

pohojnë për pasjen e rregullave të qartë, të saktë dhe të mjaftueshëm për t'u zbatuar. Edhe ato që i referohen ligjit për dokumentet zyrtare, si Këshilli i Ministrave dhe Bashkia e Tiranës, pranojnë që praktika e parashikuar në të dhe ajo e zbatuar është e saktë dhe korrekte.

1.3 Këshilli i Ministrave dhe Bashkia e Tiranës iu referohen përkatësisht ligjit për informimin mbi dokumentat zyrtare dhe Kodin e Procedurave Administrative. Përfaqësuesit e kontaktuar të këtyre institucioneve pohojnë që praktika e parashikuar në këto ligje është e saktë dhe korrekte.

1.4 Nuk vihet re ndonjë ndryshim në praktikën e ndjekur për trajtimin e një peticioni dhe të një ankese individuale në të gjithë institucionet e monitoruara. Nëse mund të flasim për dallim në trajtimin e tyre, mund të përmendet vetëm koha e trajtimit, e cila mund të jetë normale (brenda afatit 40-ditor të K.P.A) ose urgjente, kjo në varësi të objektit të trajtuar në peticion, ankesë e kërkesë.

Sipas përfaqësuesit të kontaktuar pranë Këshillit të Ministrave, objekti i trajtuar në peticion ose ankesë mund të bëjë diferencën, i cili mund të konsiderohet me përparësi dhe/ose për t'u trajtuar në një kohë sa më të shpejtë. E njëjta praktikë u përmend edhe nga përfaqësuesi i Ministrisë së Brendshme. Sipas Bashkisë së Tiranës, peticionet dhe ankesat trajtohen të njëjta, pasi ligji njih vetëm 2 ndarje: ankesa dhe kërkesa. Bashkia e Tiranës është e pajisur me një sistem elektronik, ku regjistrohen të gjitha peticionet, ankesat, kërkesat e qytetarëve, të cilat marrim automatikisht një numër protokolli dhe shpërndahen sipas objektit të tyre në sektorët përkatës.

2. Peticioni mund të dërgohet nga një individ ose një grup individësh.

2.1 A pranon institucioni juaj peticionet vetëm nga individë ose edhe grup individësh?

2.2 A kanë peticionet e individit dhe ato nga një grup individësh, të njëjtën vlerë administrative në procedimin administrativ?

2.1 Në të gjitha institucionet e monitoruara nuk vihej re një ndarje ose

diferencim në trajtimin e peticioneve dhe ankesave të mbërritura nga individë ose grup individësh. Investimi i organit ishte i njëjtë në të dy rastet, duke mos harruar të theksojmë që në rastet e dërgimit të peticioneve ato janë gjithnjë të nënshkruar nga më shumë se një person, pra nga një grup personash.

2.2 Në të dyja rastet iu jepet e njëjta vlerë administrative. Mjafton që në të dy rastet të jenë të plotësuar forma dhe kriteret për të cilat mund të vihet në lëvizje organi dhe trajtimi i tij nga institucioni publik ka të njëjtën vlerë dhe angazhim.

3. Mënyra e paraqitjes dhe forma e peticionit.

3.1 Peticionet pranohen vetëm me shkrim ose edhe me gojë? Nëse peticioni verbal pranohet, në ç' mënyrë regjistrohet ai nga nëpunësi publik? Nëse po, a i jepet një kopje për nënshkrim kërkuesit; dhe nëse jo, çfarë dëshmie i jepet atij?

3.2 Si regjistrohet mbërritja e peticionit dhe cila zyrë brenda institucionit përgjigjet për të?

3.3 Nëse peticioni regjistrohet pas deklarimit verbal, në cilën zyrë brenda institucionit realizohet kjo gjë?

3.4 Çfarë elementë të formës duhet të përmbajë peticioni që paraqitet në institucionin tuaj?

3.5 Nëse një nga elementët e formës mungon, si veproni? Në çfarë rregullash ose aktesh ligjore e nënligjorë bazoheni për vlerësimin e përmbushjes ose jo të elementeve të formës?

3.6 Nëse lejoni korrigjimin e të metave të formës nga vetë administrata, kush mund ta bëjë këtë dhe mbi bazën e çfarë rregullash?

3.7 Nëse bëni korrigjime ose peticioni ka të meta në formë, a e njoftoni kërkuesin? Nëse po, kur dhe në ç' mënyrë komunikimi?

3.8 Nëse e ktheni peticionin pas për plotësime, sa kohë/afat - nëse zbatoni ndonjë afat - i lini kërkuesit për korrigjim dhe paraqitje?

3.9 Nëse shqyrtimi i problemit të ngritur në peticion nuk është nën

juridiksionin administrativ të institucionit tuaj, si veproni?

3.1 Në të gjitha institucionet e monitoruara pranohet ana formale e marrjes së peticioneve dhe ankesave, ajo e paraqitjes me shkrim të tyre. Në Rregulloret e brendshme të institucioneve parashikohet një fakt i tillë, duke e parashikuar shprehimisht plotësimin e këtij kriteri, atë të paraqitjes me shkrim. Lidhur me faktin nëse dërguesi merr ose jo një kopje për nënshkrim, dëshmi etj., kjo pyetje mbeti pa përgjigje. Paraqitja e peticioneve dhe ankesave në mënyrë verbale është praktikë e njohur për të gjithë institucionet, me përjashtim të Kuvendit, por kjo gjithnjë e shoqëruar nga plotësimi i një formulari “tip”, i cili gjendet pranë zyrës së protokollit të institucionit. Një element tjetër që u vu re nga monitorimi ishte edhe përdorimi i sistemit elektronik pranë Bashkisë së Tiranës në regjistrimin e marrjes së peticioneve dhe ankesave me shkrim dhe verbale. Ky sistem kishte të memorizuar 80 formularë në varësi të objektit të ankesës/kërkesës së pretenduar nga qytetari.

3.2. Në gjashtë nga institucionet e monitoruara (Kuvendi, Presidenca, KM, MB, KLD dhe Avokati i Popullit), zyra e protokollit, është zyra përgjegjëse për marrjen fillestare dhe regjistrimin e peticionit/ankesës së mbërritur, nga e cila përcillet më tej praktika për trajtim. Sektori i informimit qytetar është zyra përgjegjëse përkatëse për këtë veprim pranë Bashkisë së Tiranës, zyrë ku është vendosur edhe sistemi elektronik-regjistër.

3.3 Emërtimet e zyrave pranë institucioneve të monitoruara për regjistrimin e peticioneve/ankesave verbale ndryshojnë. Përkatësisht pranë Presidencës kjo zyrë quhet Drejtoria Juridike dhe e Koordinimit, Zyra e protokollit pranë Këshillit të Ministrave, Ministrisë së Brendshme dhe KLD-së, Zyra e Pritjes me Popullin pranë Avokatit të Popullit, Sektori i informimit qytetar pranë Bashkisë.

Ndërkohë, nga të dhënat e marra nga Kuvendi i Shqipërisë, një peticion dhe ankesë mbërritur pranë Kuvendit duhet domosdoshmërisht të jetë me shkrim, pasi rregullorja e Kuvendit e ka të parashikuar këtë në mënyrë

taksative dhe nuk lë vend për mundësi të aplikimit edhe të paraqitjes verbale të tij.

3.4 Në katër nga institucionet e monitoruara, në rregulloret e tyre të brendshme është parashikuar forma që duhet të plotësojë peticioni/ankesa e paraqitur nga qytetarët për të qenë e rregullt, për t'u trajtuar prej tyre. Kështu, në rregulloren e Kuvendit, Presidencës, KLD-së dhe Avokatit të Popullit janë të parashikuar disa prej elementeve që duhet të përmbajë një peticion/ankesë i paraqitur para tyre si: emri i dërguesit, adresa e tij, shkaqe të arsyeshme dhe të kuptueshme të ankesës së paraqitur, nënshkrimin përkatës. Në tri prej institucioneve të tjera, KM, MB dhe Bashki nuk përmendet ndonjë formë e veçantë e peticionit dhe ankesës, ç'ka do të thotë që ajo konsiderohet e pranueshme, cilado qoftë forma që paraqitet. Në Bashkinë e Tiranës mjafton që peticioni dhe ankesa të përmbajnë nënshkrimin e qytetarit dërgues dhe është e mjaftueshme.

3.5 Në institucionet që e kanë të rregulluar funksionimin e brendshëm me anë të rregulloreve është bërë i qartë edhe momenti i rregullimit të anës formale të paraqitjes së peticioneve dhe ankesave. Kështu, sipas rregullores së Kuvendit, Presidencës, KLD-së, peticioni, i cili paraqet mangësi në formë kthehet pas te dërguesi për plotësime. Institucioni i Avokatit të Popullit zbaton thirrjen për intervistë me dërguesit për marrjen e sqarimeve të mëtejshme. Në tri institucionet e tjera KM, MB dhe Bashki nuk është parashikuar një çast i tillë, për sa kohë nuk është e parashikuar pasja e një forme të caktuar të peticionit dhe ankesës.

3.6 Në asnjë prej institucioneve të monitoruara nuk parashikohet korrigjimi nga vetë administrata i të metave të formës së peticionit dhe ankesës së mbërritur. Në tri prej institucioneve si Kuvendi, Presidenca dhe KLD-ja nuk parashikohet fare në rregullore korrigjimi i të metave të formës. Ndërsa, në institucione si KM, MB ose Avokati i Popullit mund të bëhen plotësime dhe ose korrigjime të peticionit/ankesës, duke u vënë në kontakt me dërguesin e tyre dhe në raste kur bëhet fjalë për çështje lidhur me përmbajtjen ose

plotësim dokumentacioni shoqërues të praktikës.

3.7 Sikurse u tha dhe më lart plotësimet dhe korrigjimet bëhen gjithnjë në komunikim me dërguesin e peticionit dhe të ankesës. Ndër format e komunikimit me ta njihen: ai postar, telefon, intervistë.

3.8 Institucionet e monitoruara, që parashikojnë mundësinë për plotësime, nuk njohin në praktikën e tyre të përditshme afate për kërkuesit ose peticion-dërguesit. Ata ua lënë vetë subjekteve në dorë, si pala e interesuar për zgjidhjen e çështjes së pretenduar. Institucioni i Avokatit të Popullit zbaton caktimin e datave për intervistë me të interesuarit, kur të gjykohet e arsyeshme nga punonjësi që ndjek çështjen.

3.9 Të gjitha institucionet e monitoruara zbatojnë komunikimin me dërguesin e peticionit/ ankesës, ku bëhet e ditur mungesa e kompetencës së tij në këtë çështje dhe orientimin drejt institucionit përkatës. Tri prej institucioneve të monitoruara, Kuvendi, KM dhe MB në raste emergjente zbatojnë të drejtën e delegimit të çështjes drejtpërdrejt tek institucioni përgjegjës.

4. Procedimi pas regjistrimit të peticionit dhe afatet.

4.1 Pas pranimit dhe regjistrimit të peticionit, cila zyrë brenda institucionit tuaj është përgjegjëse për ndjekjen e procedurës administrative?

4.2 Nga cilat kritere udhëhiqeni në procedimin e peticionit dhe së cilës zyrë i përket përgjegjësia?

4.3 Zyra që merret me çështjen e ngritur në peticion është e detyruar të njoftojë kërkuesin vetë ose vetëm nëpërmjet zyrës që ka bërë regjistrimin e peticionit?

4.4 A parashikon institucioni/zyra përkatëse seanca dëgjimore ose ballafaqime me kërkuesin?

4.5 Nëse zhvillon një procedim administrativ ose dhe hetim administrativ për çështjen e ngritur, nga cilat rregulla ligjore udhëhiqeni?

4.6 Sa është afati kohor për t'iu përgjigjur peticionit dhe në cilat akte

ligjore e nënligjore përcaktohet ky afat?

4.1 Zyrat përgjegjëse për trajtimin e peticioneve dhe të ankesave të mbërritura pranë institucioneve të monitoruara janë, përkatësisht: Në Kuvend është Kryetari i Kuvendit, i cili e kalon te komisioni parlamentar përkatës; në Presidencë është përgjegjësi i sektorit të letrave; në KM është drejtorja e marrëdhënieve me publikun, për ta kaluar për trajtim pranë sektorëve përkatës; në MB është drejtori i kabinetit, për ta kaluar për trajtim te zyra e marrëdhënieve me publikun e cila më pas e kalon tek sektorët përkatës në përputhje me çështjen; në KLD është kryeinspektori, për ta kaluar për trajtim tek inspektori, tek Avokati i Popullit është komisioneri pranë seksionit përkatës, për ta kaluar tek eksperti dhe në Bashki është drejtorja përkatëse sipas objektit të trajtuar në peticion dhe/apo ankesë.

4.2 Profesionalizmi, shpejtësia në trajtimin e rastit të shprehur me anë të peticionit, përgjegjshmëria janë ndër kriteret që udhëheqin veprimtarinë e organeve përgjegjëse për trajtimin e peticioneve dhe të ankesave në institucionet e monitoruara.

4.3 Në të gjitha institucionet e monitoruara komunikimi i mëtjshëm me dërguesin e peticionit dhe të ankesës bëhet nga zyra që është caktuar përkatësisht për trajtimin e çështjes nëpërmjet zyrës së protokollit si zyra që pret dhe përcjell çdo shkresë që vjen dhe del nga institucioni. Komunikimi bëhet vetëm në rastet kur gjykohet e arsyeshme nga nëpunësi (gjatë trajtimit të rastit) ose në përfundim të tij me dhënien e përgjigjes përfundimtare që ka rezultuar.

4.4 Në pesë prej institucioneve të monitoruara janë të parashikuara mbajtja e seancave dëgjimore me dërguesit e peticioneve dhe ankesave, në KM, MB, KLD, Avokati i Popullit dhe Bashkia e Tiranës. Seancat dëgjimore dhe ballafaqimet me të interesuarit janë një praktikë e përditshme pune pranë MB.

4.5 Kodi i Procedurave Administrative, ligji për informimin e dokumenteve zyrtare, ligjet organike të institucioneve dhe rregulloret e brendshme janë baza ligjore që rregullojnë këtë proces pranë institucioneve të monitoruara.

4.6 Në të gjitha institucionet e monitoruara respektohet afati 40 ditor i

parashikuar në Kodin e Procedurave Administrative. Por në rregulloret e institucioneve të veçanta, si Avokati i Popullit, KLD-ja ose dhe bashki përmendet edhe afati 30-ditor. Për raste që cilësohen si emergjente trajtimi i çështjes mund të shtrihet edhe për më pak kohë, një javë ose 10 ditë.

* Në këtë kre u hartua një bllok i veçantë pyetjesh shtesë për Kuvendin, për të parë me kujdes procesin e trajtimit të mbërritjes së një peticioni, si organi që ka një legjislacion më të veçantë për këtë çështje, pyetje të cilat mbeten pa përgjigje prej tij.

Blloku i pyetjeve për Kuvendin:

- A i dërgohet peticioni, siç përcakton Rregullorja Kryetarit të Kuvendit apo kjo detyrë i është deleguar dikujt tjetër? Nëse po, kush e kryen këtë funksion?

- Komisioni, që merret me çështjen e ngritur në peticion, është i detyruar të njoftojë kërkuesin vetë ose vetëm nëpërmjet zyrës që ka bërë regjistrimin e peticionit?

- Çfarë bën konkretisht Komisioni përkatës i Kuvendit? Cili person është i ngarkuar në komisionet përkatëse për referimin e peticionit?

- Nëse parashikohen seanca dëgjimore me kërkuesin, si organizohen ato?

- Nëse Komisioni ka nevojë për infomacione të mëtejshme për hulumtimin e problemeve që ngrihen, si kërkohen ato?

- Në cilat raste Komisioni autorizon Kryetarin e Komisionit, për të bërë deklaratë në seancën plenare?

- Çfarë synon të arrijë Komisioni me anë të deklaratës në seancë dhe çfarë detyrimesh ka Kuvendi, nëse ka, më pas?

- Nëse në Komisione të ndryshme ngrihen çështje që kanë lidhje me punën e më shumë se një Komisioni, cili komision prevalon në trajtimin e peticionit dhe pse? A parashikohet ndonje procedurë tjetër në këto raste?

Vlerësimi i praktikës së deritanishme

- A ju kanë ndihmuar peticionet në identifikimin e problemeve që kanë

lidhje me punën e Kuvendit (p.sh. zbatimi i ligjeve ose çështje të tjera që prekin zgjedhësit në masë)? Nëse po, çfarë ka ndërmarrë institucioni juaj në lidhje më to?

- A janë thirrur anëtarë të Këshillit të Ministrave për të dhëne shpjegime për çështje që ngrihen në peticione (mos e ngatërroi me interpelancat e deputeteve për arsye thjesht politike)?

- A ka ndodhur që si shkak i peticioneve të shumta për një fushë të caktuar, Kuvendi ose anëtarë të tij t'i kenë kërkuar Qeverisë të rishikojë legjislacionin në një fushë të caktuar? Nëse po, sa herë dhe në çfarë çështjesh? Si ka qenë reagimi i Këshillit të Ministrave?

- A ngrihen peticione në lidhje me punën e organeve të pavarura ose që japin llogari në Kuvend, dhe nëse po cili është reagimi i Kuvendit?

- Mendoni se peticionet janë një mënyrë e frytshme për Kuvendin për të kuptuar shkallën e zbatimit të ligjit në vend?

5. Përmbajtja e petitionit dhe reagimi i institucioneve.

5.1 Nëse pretendimet e kërkuarit qëndrojnë, cili është reagimi i institucionit tuaj ?

5.2 Nëse për të njëjtin problem ngrihen peticione të shumta me të njëjtin objekt, cili është reagimi i institucionit tuaj?

5.3 Nëse problemi që ngrihet vazhdimisht lidhet me aftësitë institucionale dhe organizative të institucionit tuaj cili është reagimi i institucionit? Cila zyrë ose nivel administrativ bën përgjithësimin e problemit dhe inicion propozimin?

5.4 Cili organ/zyrë brenda institucionit tuaj merr vendim për korrigjimin e problemit ?

5.5 Nëse problemi ka lidhje me akte ligjore dhe nënligjore të nxjerra nga organe të tjera, të cilat duhet të ndryshojnë, si veproni dhe cila zyrë është përgjegjëse për inicimin e saj?

5.1 Në gjashtë prej institucioneve të monitoruara në përfundim të trajtimit të çështjes së pretenduar objekt peticioni dhe ankese, institucioni ofron

zgjidhjen për dërguesin (nëse ka një të tillë), ia delegon çështjen për zgjidhje organit kompetent, operon me anë të relacioneve dhe propozimeve përkatëse brenda juridiksionit të tyre (Avokati i Popullit dhe KLD-së). Në rastet kur lind nevoja për marrjen e nismave ligjore, kjo shërben si pikënisje për zyrat kompetente brenda këtyre institucioneve për ndërmarrjen e propozimeve ligjore.

5.2 Në të gjithë institucionet e monitoruara njihej praktika e precedentit, që për raste të ngjashme do të trajtohej e njëjta përgjigje dhe zgjidhje e çështjes. Por në thelb, çdo peticion dhe kërkesë trajtohet veçmas si praktikë, për sa kohë ajo vjen si një çështje e re pranë institucionit dhe me kërkuar të veçantë. Në rastet kur çështje të tilla njësohen në kohë me ardhjen e tyre, ato mblidhen dhe trajtohen në bllok por pajisen me përgjigje më vete.

5.3 Raste të tilla trajtohen me mjaft kujdes nga institucioni për të mos lënë hapësirë për keqinterpretim të tyre nga zyrat dhe nëpunësit e tyre përkatës. Natyrisht që në secilin nga institucionet e monitoruara hasen raste të përsëritjes së peticioneve dhe të ankesave nga qytetarët dhe kjo është një e drejtë e tyre që nuk mund të kufizohet, por për çdo rast nëpunësit në shkallë hierarkike bëjnë dhe përgjithësimin e problemit dhe inicimin e propozimit.

5.4 Në të gjithë institucionet e monitoruara titullari i institucionit është autoriteti që merr vendimet për korigjimin e problemit të lindur pas peticionit/ ankesës. Në rastin e propozimeve ligjore është drejtoria juridike ajo që investohet në këtë rast.

6. Vlerësimi i praktikës së deritanishme.

6.1 Sa peticione regjistroni afërsisht në një vit?

6.2 Të çfarë natyre janë këto peticione dhe si mund të grupohen ato?

6.3 A ju kanë ndihmuar peticionet në identifikimin e problemeve që kanë lidhje me punën e institucionit tuaj? Nëse po, çfarë ka ndërmarrë institucioni juaj në lidhje më to?

6.4 Mendoni që kuadri ligjor ekzistues është i mjaftueshëm për procedimin e peticioneve? Nëse jo në ç' drejtim mund të përmirësohej ?

6.1 Në të gjitha institucionet e monitoruara vihet re një rritje e numrit të peticioneve dhe ankesave mbërritur pranë zyrave të tyre. Kështu: pranë institucionit të Presidencës janë dërguar afërsisht 2500 ankesa e kërkesa në vit; MB-ja llogarit një mesatare afërsisht 3600 ankesa në vit; KLD-ja llogarit një mesatare prej 2101 ankesa, Institucioni i Avokatit të Popullit llogarit një mesatare 4000 ankesa të ardhura në vit dhe Bashkia e Tiranës llogarit një mesatare prej 26 000 ankesa në vit.

6.2 Peticionet e mbërritura pranë institucionit të Presidencës mund të grupohen në ato që kanë të bëjnë kryesisht me pushtetin gjyqësor, prokurorinë, organet qendrore të administratës publike dhe ato të pushtetit vendor.

Peticionet e mbërritura pranë KM-së mund të grupohen në disa rubrika sipas natyrës së çështjeve: Probleme informacioni; probleme toke, probleme shkolle – të drejta studimi; probleme prone; probleme pune, probleme gjykate; probleme page; probleme pensioni; probleme shëndetësore; investime – ndërtime – kredi; probleme strehimi; probleme të ndryshme; probleme privatizimi; takime.

Peticionet e mbërritura pranë MB-së mund të grupohen sipas natyrës së tyre, të karakterit shoqëror (çështje pronësie, ndihmës sociale etj.), ekonomik, vetjake (pasaportat, gjendja civile etj.), të rendit publik (të gjitha shqetësimet e forcave të policisë), çështje të të huajve, pushtetit vendor, etj.

Ankesat e mbërritura pranë KLD-së kanë të gjitha lidhje me veprimtarinë gjyqësorë, të gjykatave dhe të gjyqtarëve.

Peticionet e mbërritura pranë institucionit të Avokatit të Popullit të natyrave të ndryshme dhe të grupuara sipas strukturës organizative të Avokatit të Popullit.

Dhe peticionet e mbërritura pranë Bashkisë së Tiranës janë ato lidhur me çështje të infrastrukturës (rrugë), zbatimin e rikonstruksionit të blloqeve të banimit (projekte që janë për to), pronarët e trojeve të ndërtimit, si dhe

çështje konkrete që lidhen me shërbimet si p.sh. taksitë.

6.3 Për institucionin e KM-së, ardhja e peticioneve dhe ankesave ka rritur ndjeshmërinë e strukturave shtetërore dhe ka ndikuar në caktimin e përparësive për reforma, si dhe në hartimin e politikave shtetërore.

Për institucionin e MB-së ardhja e peticioneve dhe ankesave ka ndikuar në ndërmarrjen e veprimeve dhe parandalimin e situatave të tilla në të ardhmen. Janë bërë raporte dhe orientime për institucionet në varësi.

Për KLD-në dërgimi dhe trajtimi i ankesave (për sa kohë nuk njihen peticione në praktikë) kanë ndihmuar disa herë në identifikimin e problemeve që kanë lidhje me punën e institucionit. Janë hartuar raporte me natyrë informimi të problemeve që ndodhin në gjykatat tona. Ka pasur ndërhyrje në aktet nënligjore për një mirëfunksionim të praktikës dhe punës së përditshme.

Për institucionin e Avokatit të Popullit, paraqitja e rekomandimeve, sugjerimeve dhe vënia në lëvizje e organeve të tjera janë ndër masat e marra në raste të tilla, në përputhje edhe me atë që parashikohet në ligjin organik të tij.

Për Bashkinë e Tiranës me anë të peticioneve është rritur ndjeshmëria e punonjësve dhe shtimi i projekteve të Bashkisë në shërbim të qytetarëve.

6.4 Sipas përfaqësuesit të KM, kuadri ligjor ekzistues është i mjaftueshëm për procedimin e peticioneve. Ajo që mund të kërkohet më shumë është puna dhe përkushtimi institucioneve në zgjidhjen e problemeve të qytetarëve. Ka nevojë për hartimin e komenteve profesionale lidhur me normat ligjore, aktet ligjore dhe nënligjore në të gjitha nivelet e qeverisjes. Ka nevojë për trajnim dhe rritje profesionale të specialistëve dhe zyrtarëve në rritjen e njohurive në trajtimin e një rasti të parashtruar në një peticion ose në kërkesën e një qytetari.

Personi i kontaktuar për MB-në nuk ishte në gjendje të propozonte ndonjë masë ose ndryshim të mundshëm për të përmirësuar praktikën e punës në këtë sektor. Për sa kohë çdo rast konkret trajtohet nga sektorët përkatës, i takon atyre të bëjnë dhe propozimet e rastit.

Për KLD-në kuadri ligjor ekzistues është i mjaftueshëm në procedimin e trajtimit të ankesave.

Për institucionin e Avokatit të Popullit ekziston e gjithë baza ligjore e nevojshme që ligjëron dhe bën të mundur funksionimin e veprimtarisë së përditshme të Avokatit të Popullit në këtë aspekt.

Për Bashkinë e Tiranës, një prej arsyeve të rishikimit të rregullores së brendshme të Bashkisë është dhe ajo e parashikimit të procedurës së trajtimit të ankesave dhe peticioneve në të. Por një domosdoshmëri për përmirësime dhe ndryshime mund të përmenden lidhur me atë që parashikon ligji për të drejtën e informimit mbi dokumentet zyrtare:

1- Afatet e trajtimit dhe të kthimit përgjigje të një ankese, (pasi afati 30 ose 40-ditor është i llogaritur edhe për ditët e pushimit (e shtunë/dielë);

2- Trajtimi i rasteve të ankesave dhe peticioneve të ripërsëritura.

Gjatë fazës së dytë të procesit të monitorimit, mars 2009, dhe në fazën e tretë maj 2009 të zbatimit të së drejtës të peticionit nga institucionet publike u përqendruam në vëzhgimin dhe analizimin e rasteve konkrete, të prekshme të peticioneve, dërguar institucioneve publike të monitoruara.

Për mbledhjen e informacionit u shfrytëzuan këto burime: mbledhje e rasteve konkrete të peticioneve, përmendur në shtypin e shkruar, takime dhe intervista me zyrtarë të institucioneve përgjegjëse.

IV. RASTE STUDIMORE

Peticion ndaj Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes për çështjen e tarifimit të faturave aforfe të energjisë elektrike

Çështja është ndjekur nga ekspertët e Avokatit të Popullit:

Institucioni i Avokatit të Popullit ka ndjekur prej disa vitesh çështjen e tarifimit aforfe të energjisë elektrike ndaj 6 familjeve në rrethin e Tiranës. Në bashkëpunim me të gjitha grupet e interesit AP ka disa vjet që është angazhuar për të përmirësuar e konsoliduar shërbimet publike që ofrojnë organet e administratës dhe të tretët që punojnë për llogari të tyre, përfshirë

edhe KESH-in. Kjo çështje ka nisur që prej vitit 2002 kur ankesat e para ishin ato lidhur me tarifimin aforfe të energjisë elektrike. Në mars 2006 AP doli me një propozim konkret, duke shpjeguar qëndrimin e tij kundër rritjes së çmimit të energjisë elektrike për konsumatorin familjar. Arsyet që AP e kundërshtoi këtë rritje, kanë të bëjnë me performancën e ulët dhe pamundësinë e KESH-it për të administruar burimet e tij ekonomiko-financiare dhe shërbimin që u ofrohet klientëve, të cilët përballen aktualisht me shkelje dhe parregullsi të dukshme ligjore gjatë furnizimit me energji elektrike.

Në mars 2008 pranë zyrës së marrëdhënieve me publikun, në AP mbërriti edhe një tjetër ankesë e disa qytetarëve që ankoheshin ndaj faturimit të parregullt me vlera joreale të energjisë elektrike. Ankesa i ishte adresuar edhe Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes në KESH dhe, për dijeni edhe Kryeministrit të vendit dhe Presidentit të Republikës.

Ankuesit janë konsumatorë të ligjshëm të KESH-it, të pajisur me kontratë dhe matës, por që sërish pretendojnë se vuajnë faturimin e parregullt dhe jo korrekt të energjisë elektrike, duke u detyruar të paguajnë vlera që nuk janë konform asaj çka lexon matësi i tyre dhe joreale të energjisë së harxhuar.

Të vënë në lëvizje nga një ankesë e tillë, AP nisi korrespondencën verifikuese me OSSH-në që prej prillit të vitit 2008. Në shkresën e tij të kësaj periudhe, AP kërkonte nga OSSH-ja shpjegime për çështjen në fjalë, me qëllim kryerjen e funksionit të tij për t'iu përgjigjur ankesës së ardhur nga qytetarët. AP përsëriti kërkesën për shpjegime nga OSSH-ja në qershor 2008 pas një përgjigje të marrë nga ky institucion, por që në fakt nuk i jep përgjigje çështjeve të ngritura nga AP në shkresën e tij.

Po në qershor 2008 AP del me rekomandimet e tij për zgjidhjen e çështjes paraqitur në ankesën e shtetasve, drejtuar OSSH-së. Rekomandimet konsistojnë në mospërsëritjen e rasteve të tilla në të ardhmen, ku konsumatorët faturohen edhe me mënyrën aforfe dhe me matës. Me këtë rast AP kërkon kthim përgjigje nga OSSH-ja për rastin konkret dhe reagimin e tij për rekomandimin e dhënë.

Në korrik 2008 përsëritet sërish shkresa e AP-së për shpjegime nga OSSH-ja, me lëndë: “Kërkesë e përsëritur për shpjegime të mëtejshme”. E njëjta kërkesë për shpjegime i dërgohet në mënyrë të përsëritur OSSH-së brenda muajit korrik 2008, në të cilën i bëhet e ditur detyrimi ligjor për të bashkëpunuar me AP dhe përgjegjësitë e tij në rast refuzimi bashkëpunimi me AP-në.

Në shtator 2008 AP del me rekomandimet e tij të dyta drejtuar OSSH gjithnjë referuar çështjes në fjalë. Kështu, AP-ja rekomandon kthimin ndaj abonentëve të shumës së paguar në mënyrë të padrejtë prej tyre, bazuar në faturat e shitjes së energjisë së nxjerrë nga OSSH-ja.

Në tetor 2008, OSSH përgjigjet AP-së me të njëjtën përgjigje të disa muajve më parë, pa marrë parasysh rekomandimet e dhëna nga AP-ja.

Një shkresë pasuese e AP ku kërkohet përgjigje për rekomandimet e AP-së lidhur me këtë çështje, i përket muajit tetor 2008. Kjo i referohet gjendjes së moskthimit të asnjë përgjigjeje nga OSSH-ja në gjithë këtë periudhë korrespondence me AP-it.

Në dhjetor 2008 ka një tjetër shkresë të dërguar OSSH-së ku kërkohet rivlerësim i qëndrimit ndaj rekomandimeve të AP. AP i kërkon OSSH-së rivlerësimin e rekomandimeve të dhëna dhe zbatim të tyre.

Në dhjetor 2008 ka një përgjigje të OSSH-së për AP, ku ridërgohen të njëjtat argumente dhe pretendimet të OSSH-së për rastin në fjalë pa përmendur aspak rekomandimet e AP-së dhe mundësinë e zbatimit të tyre.

Në këto kushte, pas një periudhe kaq të gjatë përpjekjeje komunikimi me OSSH-në dhe tashmë pas privatizimit të këtij sektori të KESH-it, AP nuk mund të vijojë më me rekomandimet e saj dhe të kërkojë zbatimin e tyre, edhe për mungesë të bazës ligjore, përse kohë OSSH është tashmë një ndërmarrje private, ku AP nuk mund të ndërhyjë dhe të operojë më me rekomandime. Me kaq mund të mbyllet e gjithë kjo praktikë peticioni/ankese drejtuar AP. (Një kopje e praktikës ndodhet në zyrën tonë, në dosjen e projektit).

Peticion i studentëve të Fakultetit Mjekësi e Përgjithshme, Universiteti i Tiranës drejtuar rektoratit të Universitetit

Të vënë në dijeni nga media e shkruar për dërgimin e një peticioni të studentëve të Fakultetit të Mjekësisë për rektoratin e Universitetit të Tiranës, u gjet me vend përfshirja e këtij rasti në raportin e monitorimit, pjesa e rasteve konkrete:

Studentët e Fakultetit të Mjekësisë i kërkojnë rektorit të Universitetit të Tiranës, Dhori Kule, të ndërhyjë për të garantuar autonominë universitare, demokracinë e brendshme dhe depolitizimin përfundimtar të strukturave të zgjedhura studentore. “Zgjedhjet për këshillat studentorë në Fakultetin e Mjekësisë, ashtu si vjet, rrezikojnë të manipulohen edhe këtë vit” - thuhet në peticionin e dërguar rektoratit të universitetit. Ky është thelbi i peticionit që i është dërguar Rektorit të Universitetit të Tiranës, i nënshkruar nga 800 nënshkrime studentësh. Studentët akuzojnë kryetarin e këshillit studentor për manipulim me votat e studentëve dhe kërkojnë ndërhyrjen e rektorit për zgjidhjen e këtij problemi.

Në takimin e zhvilluar me drejtorin e Komunikimit në Rektoratin e Universitetit të Tiranës, Ervin Demo u mor ky informacion:

Sipas z. Demo, rasti i peticionit të studentëve të Fakultetit të Mjekësisë është trajtuar me kujdes nga rektorati i Universitetit Tiranë. Me dorëzimin e tij në rektorat filluan përpjekjet për zgjidhjen e problemit të parashtruar në të, por gjatë kohës u pa që një pjesë e konsiderueshme e nënshkrimeve të nënshkruesve të peticionit ishin fiktive dhe të pasakta. Kështu, gjatë kohës së verifikimit dhe trajtimit të problemit në rektorat, erdhi një sqarim i studentëve të fakultetit të mjekësisë që pretendonin se u ishin falsifikuar nënshkrimet e tyre në peticionin e dërguar rektoratit dhe se ata nuk kishin lidhje me të. Ky fakt iu bë i ditur dorëzuesve të peticionit dhe u pa një tërheqje e tyre dhe mosinteresim i mëtejshëm për çështjen e trajtuar në peticion. Vlen për t’u theksuar që interesimi serioz i rektoratit çoi në zgjidhjen e kësaj situatë dhe shmangien e mosmarrëveshjeve në këtë fakultet. Edhe zbulimi i një situatë

nënshkrimesh fiktive që iniciuan një peticion, investoi në mirëbesim rektoratin për të trajtuar çështjen.

Peticion i Aleancës Qytetare për Mbrojtjen e Gjirit të Vlorës në kundërshtim me ndërtimin e Parkut Industrial-Energjitik (TEC) në Vlorë

Çështja e ndalimit të ndërtimit të TEC-it e nisur që në vitin 2005 pati shumë jehonë për vetë rëndësinë që iu dha nga grupi nismëtar të mbështetur nga qytetarët e rrethit të Vlorës.

Ne zhvilluam një takim me një prej drejtuesve të AQMGJV, Lavdosh Ferruni, ku u informuam për historikun e kësaj çështjeje. Z. Ferruni bëri të ditur dërgimin e disa peticioneve radhazi, të nënshkruar nga 1370 persona, në disa prej institucioneve qendrore në vend në vitin 2005, prej të cilëve nuk kishin marrë asnjëherë një përgjigje të shkruar ose verbale për çështjen që ata mbronin. Peticionet i janë drejtuar Këshillit të Ministrave, Ministrisë së Ekonomisë, Presidentit të Republikës. Të ndodhur para këtij fakti, atë të mospërgjigjes dhe reagimit zyrtar ndaj peticioneve dhe zërit qytetar, AQMGJV-ja ka përdorur edhe komunikimin me organizatat ndërkombëtare, në përputhje me Konventën e Aarhusit dhe dhënien e një karakteri politik të çështjes, duke kërkuar zhvillimin e një referendumi popullor vendor, i cili u rrezua zyrtarisht në nëntor 2005² nga Komisioni Qendor i Zgjedhjeve.

V. E DREJTA E PETICIONIT NË VENDE TË TJERA

E drejta për të paraqitur një peticion para Parlamentit European është një e drejtë “tradicionale”, e njohur fillimisht në legjislacionin e brendshëm të vendeve të BE-së. Në të drejtën komunitare, e drejta e peticionit, e ushtruar që prej vitit 1963, është përfshirë tërësisht edhe në rregulloren e Parlamentit European. Një marrëveshje ndër-institucionale midis Parlamentit European, Këshillit dhe Komisionit European e 12 prillit 1989, konfirmoi formalisht

² Vendimi i KQZ-së për refuzimin e referendumi, datë 5.12.2005, nr. 5247/2

ushtrimin e kësaj të drejte dhe sanksionoi një garanci më shumë në lidhje me trajtimin zyrtar të peticioneve.

Në nenin 194 të kreut të të drejtave themelore të Komisionit Europian, e drejta e peticionit përkufizohet si vijon:

“Çdo qytetar i Bashkimit Europian dhe çdo person fizik dhe juridik me banim ose veprimtari në një prej vendeve anëtare ka të drejtën e peticionit në Parlamentin Europian për çështje që kanë të bëjnë me fusha të veprimtarisë brenda Komunitetit dhe që prekin drejtpërdrejt atë person.”.

Neni 194 u jep të drejtën e peticionit të gjithë personave fizikë dhe juridikë, shtetas të vendeve anëtare të BE, për ta ushtruar atë personalisht dhe në grup. Marrëveshja vendos dy kushte lidhur me objektin e peticionit: 1) peticioni duhet të ketë të bëjë me një çështje që prek fushën e veprimit të së drejtës komunitare dhe 2) të ketë një impakt drejtpërdrejt te peticion-dërguesi.

Rregullorja³ e Parlamentit Europian ka të parashikuar dhe kushtet mbi anën formale dhe përmbajtjen e peticioneve dhe mënyrat se si ajo do të trajtohet. Trajtimi dhe pranimi i peticioneve kalon në dy faza:

1. Ana formale, peticioni i paraqitur para Parlamentit Europian duhet të përmbajë emrin, profesionin, kombësinë dhe adresën e përhershme të peticion-dërguesit dhe duhet të jetë i shkruar në një prej gjuhëve zyrtare të BE-së, i nënshkruar; nëse këto kushte janë plotësuar peticioni pranohet dhe regjistrohet dhe kalon drejtpërdrejt nga presidenti i Parlamentit Europian për në Komisionin e Peticioneve, përgjegjës për trajtimin e tij.

2. Përmbajtja, Komisioni i Peticioneve verifikon më tej subjektin e peticionit, i cili sipas nenit 174 të Rregullores duhet të jetë konform fushave të veprimtarisë së BE-së.

Peticion-dërguesit njoftohen për veprimet e mospranimit të peticionit së bashku edhe me arsyet e këtij veprimi. Është Komisioni i Peticioneve ai që

³ Burimi: www.europarl.europa.eu

sugjeron, sipas rastit, se cili është autoriteti kompetent në BE për trajtimin e tij ose ndonjë organ tjetër ndërkombëtar.

Në praktikë, peticionet regjistrohen në një regjistër dhe janë publik. Njoftimi për peticionet jepet në parlament, me opinionet kryesore dhe vendimet në lidhje me të; çdo gjë shënohet në procesverbalin e mbajtur, dhe me lejen e peticion-dërguesit është i gatshëm për t'u hedhur në sistemin e të dhënave i hapur për publikun. Por, nëse peticion-dërguesi bën kërkesë, peticioni trajtohet në mënyrë konfidenciale dhe futet në arkivin e parlamentit, ku edhe mund të konsultohet me deputetët.

Komisioni i Peticioneve aplikon mënyra të ndryshme të trajtimit të peticioneve. Në varësi edhe të natyrës së kërkesës së bërë (kërkesë individuale, kërkesë e bazuar në nevoja të përgjithshme ose sugjerime të Parlamentit European në lidhje me fusha të interesit të përgjithshëm) ai mund:

1. t'i kërkojë Komisionit European të ofrojë të gjithë informacionin ose një opinion për çështjet e ngritura nga peticion-dërguesi;
2. të organizojë seanca, ku do të diskutohen të dhënat e rastit trajtuar në peticion;
3. të dorëzojë peticionin tek Ombudsmeni European;
4. të kërkojë mendimin e komisioneve tjera parlamentare dhe, për më tepër, kur objekt i peticionit është amendimi i një ligji.

Në rastet e interesave vetjake:

1. Komisioni i Peticioneve mund të ndërhyjë në kontakt me autoritetet kompetente ose me përfaqësues të vendeve anëtare në fjalë;
2. Komisioni i Peticioneve mund të ftojë, gjithashtu, Presidentin e Parlamentit European të ndërhyjë në autoritetet e vendeve përkatëse.

Në rastet e interesave të përgjithshme:

1. Kur arrihet në përfundim që peticioni është pasojë e një shkeljeje të ligjit komunitar, Komisioni European do të nisë me procedimin në Gjykatën Europiane të të Drejtave për goditjen e aktit;
2. Komisioni i Peticioneve mund t'i kërkojë Presidentit të Parlamentit European të dërgojë opinionin e tij/saj Këshillit ose Komisionit European.

Nga një vëzhgim i kushtuar legjislacioneve të vendeve europiane rezulton që e drejta e peticionit është e parashikuar gjerësisht në kushtetutat e tyre, si pjesë e të drejtave themelore të njeriut. Në disa prej vendeve të BE-së, e drejta e peticionit është e rregulluar me ligj të posaçëm, si:

Gjermania

Kushtetuta (neni 17)

Kushdo ka të drejtën, vetëm ose në grup me të tjerë, t'i drejtojë kërkesa ose ankesa organeve kompetente dhe parlamentit.

Statutet e organeve të shërbimit ushtarak, dhe atij rezervë mund, sipas parashikimeve, të aplikohen edhe tek anëtarët e Forcave të Armatosura dhe të shërbimeve rezervë gjatë periudhës së shërbimit ushtarak, të kufizojnë ligjin bazë (...), dhe e drejta e peticionit të aplikohet (neni 17) pasi kjo e drejtë lejon pranimin e kërkesave dhe ankesave bashkë me të tjerat. (...)

Dhoma e Përfaqësuesve [Bundestag] cakton një Komision për peticionet që të merret me kërkesat dhe ankesat e drejtuara kësaj Dhome, sipas nenit të peticioneve (neni 17).

Kompetencat e këtij komisioni janë të rregulluara në një statut të veçantë.

Estonia

Kushtetuta (neni 46)

“Kushdo ka të drejtën t'i drejtohet organeve shtetërore organeve të pushtetit vendor dhe zyrtarëve të tyre me kërkesa dhe të peticioneve. Procedura e ndjekjes së këtyre akteve rregullohet me ligj.”

Greqia

Kushtetuta (neni 10)

Çdo person ose grup personash kanë të drejtën, sipas ligjeve të shtetit, t'u drejtojnë peticione autoriteteve dhe këto të fundit duhet t'u përgjigjen menjëherë mbi bazën e rregulloreve të shkruara dhe pajisin me një përgjigje të shkruar për peticion-dërguesin në përputhje me ligjin (...)

Lituania

Kushtetuta (neni 33)

Qytetarët duhet të kenë të drejtën të marrin pjesë në qeverisjen e vendit drejtpërdrejt dhe nëpërmjet të zgjedhurve të tyre, sikurse dhe të kenë të drejtën të përfitojnë shërbimin shtetëror në kushte të barabarta.

Qytetarët duhet të kenë të garantuar të drejtën të kritikojnë punën e institucioneve shtetërore dhe të nëpunësve të tyre dhe të kundërshtojnë vendimet e tyre. Nuk lejohet akuza për qëllime thjesht kritike.

Qytetarëve iu garantohet e drejta e peticionit; procedura për zbatimin e saj vendoset me ligj.

Austria

Ligji Federal (neni 148a)

3) Është e parashikuar në detyrat e Ombudsman-it të marrë pjesë në zgjidhjen e peticioneve dhe ankesave në grup paraqitur në Kuvend. Ligji federal ka të specifikuar detajet mbi to.

Polonia

Kushtetuta (neni 63)

“Cilido ka të drejtën të bëjë peticione, kërkesa dhe ankesa me interes publik, interes vetjak ose të një personi tjetër – me lejen e tij – drejtuar organeve publike, si dhe organizatave dhe institucioneve sociale, në lidhje me performancën e tyre brenda fushës së administratës publike. Procedura për trajtimin e peticioneve, kërkesave dhe ankesave rregullohet me ligj” .

Në vende të tjera europiane rregullimi i kësaj të drejtë është bërë me legjislacion dytësor, në zbatim të asaj çka është e sanksionuar në Kushtetutë. Me poshtë po rendisim dispozitat kushtetuese mbi të drejtën e peticionit në disa prej vendeve të BE-së.

Republika Çeke

Kushtetuta (neni 18)

(1) E drejta e peticionit është e garantuar; cilido ka të drejtën t'i drejtojë vetë ose bashkë me të tjerë, organeve të shtetit ose atyre të vetëqeverisjes vendore me kërkesa, propozime dhe ankesa mbi çështje të interesit publik ose të përbashkët.

(2) Peticioni nuk mund të përdoret për të ndërhyrë në pavarësinë e gjykatave.

(3) Peticionet nuk mund të përdoren për qëllime ankimi, për të shkelur të drejtat themelore dhe liritë e njohura në ligj.

Italia

Kushtetuta (neni 50)

Të gjithë qytetarët kanë të drejtën e peticionit ndaj Kuvendit, për të kërkuar ndryshime ligjore ose plotësimin e nevojave tjera.

Hungaria

Kushtetuta (neni 64)

Në Republikën e Hungarisë cilido ka të drejtën të paraqesë, vetëm ose bashkë me të tjerë, peticione të shkruara ose ankesa drejtuar autoritetit përkatës.

Portugalia

Kushtetura (neni 52)

Të gjithë qytetarët kanë të drejtën të paraqesin vetëm ose në grup me të tjerë, peticione, kërkesa, pretendime ose ankesa ndaj organeve me autoritet të lartë ose çdolloj autoriteti, me qëllimin e mbrojtjes së të drejtave të tyre, këtë kushtetutë, ligj ose interes të përgjithshëm, si edhe të drejtën për t'u informuar brenda një kohe të arsyeshme.

Slovenia

Kushtetuta (Neni 45)

Cilido qytetar ka të drejtën e peticionit dhe të ndjekjes së nismave të tjera me interes të përgjithshëm.

Slovakia

Kushtetuta (neni 27)

E drejta e peticionit është e garantuar. Cilido person ka të drejtën t'u drejtohet autoriteteve qeveritare dhe administratës publike për çështje të interesit vetjak dhe publikime peticione, propozime dhe ankesa vetë ose në bashkëpunim me të tjerë.

Peticioni nuk mund të përfshijë trajtimin e të drejtave dhe lirive themelore.

Hollanda

Kushtetuta (neni 5)

Cilido ka të drejtën e dorëzimit të peticioneve të shkruara autoriteteve kompetente.

Luksemburgu

Kushtetuta (neni 27)

Cilido ka të drejtë e peticionit të nënshkruar nga një ose më shumë persona drejtuar autoriteteve publike. Vetëm organet e rregjistruara kanë të drejtën e dërgimit të peticioneve kolektive.

Neni 67

Peticionet dërguar Kuvendit nuk duhen bërë vetë.

Kuvendi ka të drejtë t'ia referojë anëtarëve të Qeverisë çdo peticion drejtuar atij. Anëtarë të qeverisë duhet të japin shpjegime mbi përmbajtjen e tyre kurdoherë që Kuvendi e kërkon.

Kuvendi nuk merret me peticione që burojnë nga interesa private, vetëm nëse ato ka ardhur si pasoje e akteve të paligjshme të qeverisë dhe autoriteteve ose, nëse janë marrë vendime që ndërhyjnë në kompetencat e Kuvendit.

Qipro

Kushtetuta (neni 29)

1. Çdo person ka të drejtë vetëm ose bashkë me të tjerë të drejtojnë kërkesa të shkruara ose ankesa çdo autoriteti publik dhe të ndiqen prej tyre dhe në marrjen e vendimeve; një njoftim i menjëhershëm për vendime të marra i jepet personit që ka bërë kërkesën ose ankesën brenda 30 ditëve.

2. Kur çdo person i interesuar preket nga një vendim i tillë ose kur një vendim i tillë nuk i është bërë i njohur personit brenda kohës së afatit të parashikuar më lart, personi mund të bëjë ankim në gjykatën kompetente për çështje të lidhura me këtë kërkesë ose ankesë.

Danimarka

Kushtetuta (neni 54)

Peticionet mund të dorëzohen në parlament vetëm nëpërmjet anëtarëve të tij.

VI. NEVOJA PER NDRYSHIME DHE PROPOZIME LIGJORE

Disa zëra bashkë janë gjithnjë më të lartë se një i vetëm. Me këtë në mendje, që qytetarët të arrijnë të përdorin një petition në mënyrë sa më efektive duhet të bashkohen për një çështje të përbashkët sa më shumë njerëz dhe mbështetja do të jetë më e mundur.

Ushtrimi i së drejtës së petitionit dhe të ankesës është me rëndësi për të gjithë qytetarët, por, gjithashtu, edhe për vetë institucionet shtetërore, pasi ato përfitojnë nga burimet e drejtpërdrejta të informacionit lidhur me shqetësime të qytetarëve dhe vështirësitë që ata hasin gjatë veprimtarive të përditshme në zbatim të ligjit, të cilat mund të çojnë në raste të keqinterpretimit të tij ose edhe të moszbatimit. Dërguesit dhe ankuesit e petitionit mund të identifikojnë hapësira ligjore dhe nevojën për rregullime dhe përmirësime të tij.

Numri i peticioneve, por më së shumti ai i ankesave, dërguar institucioneve publike ka ardhur në rritje. Këtë e pohojnë vetë personat e kontaktuar pranë institucioneve të monitoruara dhe në perceptimin fillestar të çështjes lind

pyetja se pse ka ardhur një rritje e tillë dhe çfarë duhet bërë më shumë për të rregulluar dhe pasur nën kontroll këtë situatë.

Në vijim të asaj ç'ka është parashtruar në lart, do të japim rekomandimet tona, me qëllimin e mirë që situata të lehtësohet disi dhe qytetarët të jenë edhe më në mirëbesim të institucioneve për zgjidhjen e problemeve parashtruar prej tyre.

REKOMANDIME

Nga analiza ligjore e përfshirë në pjesën e parë të këtij raporti, pamë të vetmet rregullime ligjore që ka e drejta e peticionit, si një e drejtë kushtetuese, janë dispozitat e Kodit të Procedurave Administrative dhe rregulloret e brendshme të institucioneve. Më shumë sesa rregullim për ushtrimin e peticioneve, keto janë për të rregulluar trajtimin e ankesave dhe të kërkesave të ardhura në to. Pra, nuk ka një praktikë uniforme dhe të njëjtë për trajtimin e peticioneve dhe ankesave.

Në këtë kuadër, mbi bazën e vlerësimit të bërë nga analiza paraprake e legjislacionit dhe e përfundimeve të raportit të monitorimit në shtatë prej institucioneve publike, janë hartuar disa rekomandime që synojnë ngritjen dhe përmirësimin e standardeve, në zbatim të respektimit të një të drejte kushtetuese të peticionit dhe të ankesës, si më poshtë:

1. Të rishikohet bashkëveprimi mes institucioneve publike me qëllim shkëmbimin e përvojave në funksion të trajtimit të peticioneve, ankesave dhe kërkesave. Kjo formë bashkëpunimi, e cila mund të jetë e institucionalizuar disi midis organeve qendrore dhe atyre në varësi (të tyre), të bëhet e mundur midis të gjithë organeve publike, me qëllim lehtësimin e pjesëmarrjes së publikut në to dhe rritje të përgjigjshmërisë e tyre ndaj qytetarëve.

Ne sugjerojmë vendosjen e rregullave të njëjtë, duke shmangur rastet për abuzime ose vonesa në trajtimin e rasteve konkrete. Le të jetë e rregulluar në mënyrë taksative që vetë organi të dërgojë çështjen për trajtim tek organi kompetent, bashkangjitur një njoftimi për dërguesin.

2. Të unifikohet praktika trajtuese e një peticioni, ankese dhe kërkesë në secilin prej institucioneve publike, brenda një pushteti të caktuar, p.sh. pushteti ekzekutiv. Të gjitha ministratë do të ishte mirë që në aktet e tyre të brendshme, si p.sh rregulloret të parashikojnë të njëjtën procedurë për peticionet, ankesat e kërkesat, duke vendosur kështu uniformitetin dhe njësimin e praktikës së trajtimit të tyre.

3. Të rishikohen afatet që rregullojnë procesin e trajtimit të peticioneve, ankesave dhe kërkesave në rastet kur këto kthehen për plotësime te dërguesi i tyre. Lënia e një afati të pacaktuar për plotësimin e pasaktësive dhe të mangësive të të dhënave, dokumenteve të një rasti peticioni, ankese dhe kërkesë sjell zvarritje dhe të dhëna fiktive të çështjeve që adresohen për zgjidhje pranë institucioneve publike. Kjo situatë mund të rregullohet duke caktuar një afat konkret për dorëzimin e tyre nga dërguesit e peticionit, ankesës e kërkesës kundrejt një parashikimi për arkivim të çështjes, nëse ajo nuk kthehet e plotësuar brenda këtij afati.

Gjithashtu, të rishikohen afatet ligjore për trajtimin e peticioneve, të ankesave dhe kërkesave të përsëritura. Në situatat kur një peticion, ankesë ose kërkesë dërgohet në mënyrë të përsëritur pranë një institucioni publik sugjerohet të caktohet një afat për trajtimin e tij, i ndryshëm nga ai fillestar, i parashikuar në ligj. Afati i sugjeruar mund të jetë më i shkurtër, p.sh. 30 ditë, për vetë kohën që ai mund të duhet të trajtohet dhe për dërgimin e përgjigjes tek i interesuari.

4. Të unifikohet terminologjia e ndryshme, e gjendur në ligje të ndryshme, për peticionin dhe ankesën. Të zbatohet hartimi i komentareve të neneve të veçanta, i ligjeve dhe Kushtetutës, për të bërë të mundur përafrimin e tyre në mënyrë që punonjësi që merret me marrëdhëniet me publikun të ketë të qartë se kur procesi ka të bëjë me një peticion dhe kur është një veprimtari normale e administratës, me qëllim rritjen e performancës së tyre në punë.

5. Të përmirësohet ura e komunikimit midis institucioneve dhe publikut; të synohet mënyra më e shpejtë dhe efektive e mundshme. Të zbatohen mënyrat e reja të komunikimit, si ai elektronik. Për peticione të interesit të

përgjithshëm mund të shfrytëzohet edhe publikimi i tyre në faqet e internetit të institucioneve përkatëse.

Është me rëndësi të përmendim që në përgjigje të një peticioni, ankese ose kërkesë dërguar një institucioni, institucioni jo vetëm duhet të kthejë një përgjigje (pozitive ose negative ciladoqoftë) sipas rastit konkret drejtuar peticion-dërguesit, por të zbatohen edhe metodat e veprimit me anë të vendimeve dhe politikave shtetërore ndaj çështjeve të përmendura në to.

6. Zbatimi i sistemeve të informacionit (database) në marrjen e të dhënave dhe ndjekjen e çështjeve të peticionit dhe ankesave. Në një kohë që digjitalizimi është bërë pjesë e operimit të administratës në punën e saj të përditshme, zbatimi i sistemeve të informacionit do të gjykohej shumë pozitiv që me marrjen e peticionit, ankesës dhe kërkesës dhe dërgimin e tij automatikisht te sektori përgjegjës për trajtim. Kjo formë kursen kohë dhe energji njerëzore.

7. Të gjendet një mekanizëm që të vlerësojë nënshkrimet e atyre që shkruajnë peticion për të shmangur rastet e peticioneve fiktive.

PËR ROLIN E KUVENDIT

Propozojmë:

1. Krijimin e një rrjeti komunikimi midis Kuvendit dhe organeve të ekzekutivit, për një monitorim më të mirë të peticionit dhe pasojave që ai duhet dhe mund të sjellë në rregullimin e çështjes për të cilat është hartuar.

Të rishikohet roli i Kuvendit si monitorues dhe kontrollues i organeve të ekzekutivit në çështjet e trajtimit të peticioneve dhe ankesave. Kjo duhet të vihet në funksion edhe të përmirësimit të detyrimit moral e politik të deputetëve ndaj zgjedhësve të tyre.

2. Ngritja e një database, me akses të plotë në informacionin për ndjekjen e peticionit.

3. Ngritja e një komisioni të veçantë për trajtimin e rastit objekt peticioni, në rastet e shkeljeve të ligjit, të cilat mund të kenë konsekuenca serioze më së shumti në çështje që kanë të bëjnë me mjedisin, mbrojtjen e konsumatorëve

ose trashëgiminë kulturore.

BIBLIOGRAFIA

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë

Kodi i Procedurave Administrative, ligji nr. 8485, datë 12.05.1999

Ligji për Avokatin e Popullit, nr. 8545, datë 04.02.1999

Vendimi i Gjykatës Kushtetuese, nr 49, datë 31.07.2000

Ligji mbi të Drejtat e Informimit mbi Dokumentet Zyrtare, nr. 8503, datë 30.06.1999

Rregullore e Kuvendit, miratuar nga Kuvendi me vendimin 166, datë 16.12.2004

Ligji mbi Organizimin dhe Funksonimin e Këshillit të Ministrave, nr. 9000, datë 30.1.2003

Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 584 datë 28.08.2003 “Mbi miratimin e rregullimeve të Këshillit të Ministrave”

Website të institucioneve si: Presidenti i Republikës, Këshilli i Ministrave, Kuvendi i Shqipërisë, Ministria e Brendshme, Këshilli i Lartë i Drejtësisë, Avokati i Popullit, Bashkia Tiranë (www.president.al, www.keshilliministrave.al, www.kuvend.al, www.moi.gov.al, www.kld.al, www.avokatipopullit.gov.al, www.tirana.gov.al).

Takime dhe intervista me administratorë të institucioneve të monitoruara: Elham Sharra, drejtor i marrëdhënieve me publikun në KM; Fatjona Memçaj drejtor juridik në Presidencë; Arta Sakja, drejtor i shërbimit të informacionit dhe dokumentacionit në Kuvendin e Shqipërisë; Artur Lazebeu, drejtor kabineti në Avokatin e Popullit; Drita Marena, specialiste e marrëdhënieve me publikun në MB; Elda Vrioni inspektore në Inspektoriatin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë; Manjola Sopotit përgjegjëse sektori i informimit qytetar në Bashkinë e Tiranës, Lavdosh Ferruni, përfaqësues i AQMGJV; Ervin Demo, drejtor i komunikimit në rektoratin e UT.

Kushtetutat e vendeve të BE dhe Rregullorja e Parlamentit Europian marrë nga www.europarl.europa.eu

Information paper: www.learningtogive.org

Peticioni, sa ia vënë veshin?

*Petro Koçi
Politikan*

E drejta për peticion, ankimim dhe kërkesa është e sanksionuar në Kushtetutë dhe në ligje ose rregullore të veçanta. Mund ta ushtrojë çdo qytetar i Republikës së Shqipërisë, vetëm ose në grup.

Peticioni, kërkesa dhe ankesa ndryshojnë në koncept nga njëra-tjetra. Tek asnjë ligj ose rregullore në fuqi nuk pasqyrohet ky dallim. Ky konstatim vlen të shërbejë si një sugjerim për të reflektuar në përmbajtjen ligjore të mëvonshme që trajton të drejtën e peticionit, ankesës dhe kërkesës, si edhe procedurat e detyrueshme të përgjigjes dhe ndjekjes së tyre.

Gjithsesi, duke nënkuptuar këtë dallim, përdorimi i termit “peticion” besoj se mjafton për të siguruar mirëkuptimin e lexuesit.

Peticioni përbën një instrument veprues në funksion të demokracisë dhe mirëqeverisjes. Pushteti i qytetarit ka shansin të ushtrohet jo vetëm një herë në katër vjet, ku zgjedh organet qeverisëse, por edhe në periudhën ndërmjetëse.

Përgjigjja ndaj peticionit ndikon fuqishëm edhe në përcaktimin e pëlqimit zgjedhor ose politik. Gjithnjë e më shpesh vihen re raste të orientimit të votës politike në bazë të reflektimit të treguar ndaj kërkesave të bashkësive të ndryshme.

Peticioni vendos në provë raportin e shtetit dhe të institucioneve me shoqërinë dhe qytetarin. Shkalla e përgjegjshmërisë ndaj peticioneve dëshmon nivelin e shërbyeshmërisë së shtetit ndaj shtetasve. Përballja me peticionin rrit ose jo përgjegjshmërinë e autoriteteve shtetërore dhe politike.

Ushtrimi i të drejtës për peticion rrit mirëqenien demokratike dhe

shurdhëria e mundshme e institucioneve ndaj tyre dëshmon largimin e shtetit nga interesat e qytetarëve.

Koha ka treguar se shpesh peticionet kanë vënë në lëvizje ndryshimin ligjor, sidomos në ligje me efekte sociale, pra kanë ndikuar në rritjen e përmasës sociale të shtetit dhe politikës. Kjo ka ndodhur sidomos në ligje që trajtojnë pensionet e shtresave ose të profesioneve të caktuara.

Kushtetuta, Kodi i Procedurës Administrative ose dhe rregullore të ndryshme parashohin ushtrimin e të drejtës për peticion dhe përcaktime detyruese lidhur me paraqitjen formale të kësaj të drejte, si edhe në disa raste edhe mënyrën ligjore të trajtimit të tyre.

Analiza e përmbajtjes ligjore e bën të qartë se nuk ka një kuadër ligjor të njehsuar për trajtimin e peticioneve nga organe të ndryshme qeverisëse ose institucione të tjera.

Kryeministria dhe Bashkia e Tiranës, për shembull, i trajtojnë peticionet me rregullore të brendshme në kuadër të trajtimit të shkresave ose dokumenteve të ndryshme.

Nga studimi i kuadrit ligjor dhe monitorimi në disa institucione të rëndësishme qendrore i procedurave në trajtimin e peticioneve del i qartë përfundimi se është e nevojshme të hartohet dhe të miratohet një ligj i njehsuar që garanton standarde të detyrueshme dhe përgjegjësi përcaktuese në trajtimin e peticioneve.

Avokati i Popullit mbetet organi më i specializuar në trajtimin e peticioneve. Duket qartazi se në funksionimin e këtij institucioni gjendet mundësia për përgjithësime të sakta dhe dobiprurëse në këtë fushë. Kjo edhe sepse përgjigjet e munguara të peticioneve në institucione të tjera nxisin nënshkruarit përkatës të provojnë reagimin e Avokatit të Popullit, i cili me të drejtë mund të quhet edhe avokati i peticioneve të popullit. Fuqia institucionale e këtij institucioni, e bazuar në Kushtetutë, ka vënë shpesh në provim publik shkallën e përgjigjes së institucioneve të ndryshme ndaj të drejtave të njeriut, ku përfshihet e drejta për peticion.

Në hartimin e mundshëm të një ligji unifikues Avokati i Popullit do të ishte një këshilltar me përvojë të pazëvendësueshme.

Presidenti, Kryeministria, ministrinë, bashkitë etj. janë, gjithashtu, institucione ku trajtimi i peticioneve përbën volum pune dhe kulture ligjore e demokratike për t'u përgjithësuar e natyrisht korrigjuar në mënyrë të njehsuar.

Njehsimi duhet të fillojë nga unifikimi i terminologjisë dhe deri tek ai i procedurës së ndjekjes së peticioneve.

Duhet një përcaktim më i qartë i afateve në procesin e trajtimit dhe përgjigjes ndaj peticioneve. Afatet kanë një rëndësi thelbësore, përfshirë dhe ato të mirëplotësimit ose korrigjimit të formaliteteve.

Nevoja për një shkëmbim të shpeshtë përvojash duhet pasqyruar në nisma të orientuara drejt përmirësimit ligjor e rregullator.

Kuvendi i Republikës ka përgjegjësi të madhe për të luajtur në këtë drejtim. Jo vetëm si hartues e miratues ligjesh, por edhe si monitorues i ekzekutivit dhe si institucion kushtetues ku formohen institucione të tjera dhe ku ato raportojnë herëpashere në mënyrë ligjore.

Komisionet e Përhershme të Kuvendit, të posaçme ose vetë deputeti, në zbatim të statusit të tij, duhet të jenë më aktivë ndaj garantimit të përgjigjes ligjore ndaj peticioneve të ndryshme. Ky detyrim nuk përfshin vetëm peticionet e ardhura në Kuvend, por edhe ato të adresuara në institucione ose organe të tjera qeverisëse.

Të mos harrojmë se Kuvendi formohet nga pushteti i votës së qytetarit dhe detyrimi i këtij institucioni dhe i anëtarëve të tij është moral dhe politik. Një Kuvend më kushtetues, në raport me ekzekutivin, do ndryshonte në favor të mirëqenies së demokracisë raportin e qytetarit me politikën dhe shtetin.

Trajtimi i peticioneve, kërkesave dhe ankesave kërkon një infrastrukturë moderne dhe të shpejtë komunikimi.

Demokracia fiton vetëm nga kultivimi i ushtrimit të së drejtës për peticion. Ndjekja publike e fatit të disa peticioneve ka ndikuar në reagimin më të gjerë

se nënshkruesit për çështjen, si edhe ndaj institucioneve të lidhura përkatësisht. Çështje të mjedisit në Vlorë, Shkodër, Durrës etj. kanë nxitur reflektime politike dhe intelektuale të gjera dhe shpesh kanë mbizotëruar axhendën e medias ose të institucioneve.

Peticionet mbeten një ushtrim masiv edhe në arsim, në marrëdhëniet universitet-student ose në atë MASH-student.

Nisur nga këto zhvillime peticionet shpesh janë shndërruar në nisma për referendume, institucion ende i pakultivuar dhe i paushtruar te ne. Kjo është një dukuri që dëshmon varfërinë tonë demokratike dhe frikën e politikës ndaj pushtetit të qytetarit. Në fund të fundit, e drejta për t' u ankuar garantohet, por sa u vihet veshi ankimeve e peticioneve? Kjo është çështja.

zgjedhore për transparencën e financimeve jopublike të këtyre subjekteve gjatë

Numri XLV, viti 2008

40

Raport: Monitorimi i financimit të fushatës zgjedhore dhe zbatimit të ligjit mbi transparencën e subjekteve zgjedhore gjatë zgjedhjeve parlamentare të vitit 2009

Qendra e Studimeve Parlamentare

I. HYRJE

Qendra e Studimeve Parlamentare (QSP), me mbështetjen financiare të Fondacionit Shoqëria e Hapur (Soros) ka zhvilluar një monitorim të shtrirë në dy faza, në vlerësim të zbatimit të detyrimeve ligjore prej subjekteve zgjedhore në lidhje me transparencën e financimeve jopublike të këtyre subjekteve gjatë zgjedhjeve parlamentare të vitit 2009.

Detyrimet ligjore të subjekteve politike në lidhje me transparencën e financimeve jopublike gjatë zgjedhjeve të përgjithshme të 29 qershorit burojnë nga Kodi i Ri Zgjedhor, i cili u miratua nga Kuvendi i Shqipërisë, në përputhje me Kushtetutën e Shqipërisë. Kodi Zgjedhor rregullon të drejtat dhe detyrimet e subjekteve zgjedhore në lidhje me financimet që subjektet përfitojnë gjatë periudhës zgjedhore, sipas normave të përcaktuara me ligj.

Financimi i subjekteve dhe fushatave zgjedhore përbën një nga çështjet që ndikon në mënyrë të drejtpërdrejtë në zhvillimin e zgjedhjeve dhe rezultatet e tyre. Mënyra e rregullimit ligjor të kësaj çështjeje, zbatimi dhe vlerësimi në praktikë i respektimit të kërkesave ligjore do të reflektohet në arritjen e standardit për zgjedhje të lira dhe të ndershme si dhe në besimin e publikut tek forcat politike.

Monitorimi ka patur objekt vlerësimi nivelin e transparencës së subjekteve politike zgjedhore në respektim të detyrimeve që ligji iu njuh këtyre subjekteve për të deklaruar financimet jopublike që sigurojnë gjatë periudhës zgjedhore.

Monitorimi synon të vlerësojë nivelin e zbatimit të ligjit nga ana e subjekteve zgjedhore në lidhje me deklarimin e financimeve jopublike, duke konsideruar njëkohësisht vullnetin politik të subjekteve dhe infrastrukturën që e mundëson zbatimin e ligjit në nivel politik dhe institucional.

Ky monitorim synon po ashtu të adresojë krijimin e procedurave sa më korrekte dhe të plota për të parandaluar shmangien nga kërkesat ligjore dhe shkeljen e barazisë në fushatë si edhe krijimin e mekanizmave për monitorimin dhe transparencën e këtyre financimeve gjatë fushatës zgjedhore, duke gjykuar mbi një panoramë tërësore të shkallës së transparencës që adaptojnë subjektet zgjedhore, efikasitetit të zbatimit të ligjit për transparencën financiare.

Ky projekt synon të ndihmojë në hartimin e rekomandimeve të nevojshme dhe adresimin në mënyrën e duhur të çështjeve që do t'i shërbejnë një zbatimi sa më të plotë të ligjit zgjedhor për transparencën e financimeve të subjekteve politike zgjedhore.

II. METODOLOGJIA

Zbatuesit e projektit për zhvillimin e monitorimit fillimisht bënë një analizë të kuadrit ligjor që rregullon detyrimet e subjekteve zgjedhore për transparencë financiare. Gjatë analizës u konsultuan Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë si dhe aktet nënligjore përkatëse. Gjithashtu, u vlerësua jurisprudenca e disponueshme në këtë fushë si dhe raporte të tjera të institucioneve monitoruese ndërkombëtare.

Pas analizës u identifikuan standardet ligjore, të cilat duhet të respektohen nga subjektet zgjedhore. Gjithashtu, u hartuan pyetsorët në bazë të këtyre standardeve, si instrumente të nevojshme për të mbledhur informacionin që kërkohet, për të bërë vlerësime sa më objektive.

Pyetësorët iu adresuan dy subjekteve kryesore politike në vend, Partisë

Socialiste dhe Partisë Demokratike, si edhe Komisionit Qendror të Zgjedhjeve si një institucion rregullator dhe mbikqyrës i këtij procesi. Në bazë të këtyre pyetësorëve, u synua një qasje e adresuar e problemeve që mund të shoqërojnë këtë rregullim të ri ligjor, i cili nuk trashëgon një traditë të mëparshme të standartit të sjelljes së subjekteve zgjedhore si në aspektin ligjor ashtu dhe të moralit politik në vend.

Përveç gjetjeve empirike, atyre analitike nga pyetësi, vlerësimit konkret në terren të situatës, etj. konsulenti mori në analizë të detajuar edhe Auditet Financiare Zyrtare të dy subjekteve kryesore në lidhje me raportimin zyrtar të tyre në KQZ.

Konkluzionet tërësore u ballafaquan gjithashtu me raportin zyrtar të nxjerrë nga Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve në lidhje me transparencën financiare, në përmbushje të këtij detyrimi ligjor.

III. ANALIZË E BACKGROUND-IT HISTORIK DHE LIGJOR

Në legjislacionin shqiptar çështja e transparencës së financimeve publike të subjekteve zgjedhore rregullohet nga Ligji Nr. 7502 datë. 25.07.1991, i amenduar pjesërisht në nene të veçanta me Ligjet Nr. 7591, 7818 dhe 8324.

Ky ligj i njeh partive politike statusin e personit juridik (neni 17), ndërsa përkufizon si burime financiare dhe materiale të tyre:

1. kuotat e anëtarësisë;
2. çdo pasuri e fituar në mënyrë të ligjshme;
3. të ardhurat nga veprimtaria ekonomike e social-kulturore;
4. ndihma financiare në masën e caktuar në buxhetin e shtetit, të miratuar me ligj nga Kuvendi Popullor.(neni 18)

Ky ligj ende në fuqi nuk i njeh si burime financimi donacionet jopublike, që mund të vijnë nga persona fizikë ose juridikë privatë.

Neni 22 i këtij ligji specifikon: “Për çdo fushatë elektorale kombëtare ose lokale jepen ndihma financiare të veçanta nga buxheti i shtetit, sipas kriterëve të caktuara në ligjet elektorale”.

Neni 23 veçon: “Ndalohen ndihmat financiare dhe materiale nga shtetet dhe entet publike a private të huaja. Lejohen dhuratat dhe ndihmat kur vijnë nga parti a bashkime ndërkombëtare partish, deri në masën që nuk kalon ndihmën financiare të dhënë nga shteti”.

Neni 24 specifikon më tej: “Ndalohen ndihmat financiare dhe materiale për partitë politike nga entet publike të vendit, si dhe nga entet me pjesëmarrjen e kapitalit shtetëror”.

Në asnjë rast nuk përmenden donacionet jopublike vendase, as në periudhë zgjedhore. Këto financime, ligjërisht nuk përbëjnë zë në buxhetin e subjekteve politike.

Neni 26 përkufizon skemën e raportimit ekonomik-financiar të partive politike, pa e njohur këtë zë: “Në fund të vitit kalendarik, partitë paraqesin raportin e veprimtarisë së tyre ekonomik-financiare, i cili shqyrtohet nga një komision ekspertësh i ngritur për këtë qëllim nga Kuvendi Popullor. Ky komision ka të drejtë të kontrollojë të gjithë veprimtarinë ekonomik-financiare të partive. Raporti përfundimtar i këtij komisioni i paraqitet Kuvendit Popullor”.

Në fakt Kushtetuta, si ligji themeltar i shtetit vendos në një qasje parimore standarte, transparencën e burimeve financiare në pjesën e saj të parë, ku përfshihen Parimet Themelore. Kështu në nenin 9/3 Kushtetuta sanksionon “Burimet financiare të partive, si dhe shpenzimet e tyre bëhen kurdoherë publike.” Porse ky ligj kushtetues nuk ka gjetur rregullim dhe shtrirje as në Ligjin për Partitë Politike dhe as në Kodin e mëparshëm zgjedhor, ku kishte vetëm një nen në kapitullin e pestë “Financimet dhe Buxheti i KQZ-së”, ku thuhej se “Çështjet që lidhen me financimin e subjekteve zgjedhore miratohen me vendim të KQZ-së”(neni 52).

Jo vetëm gjatë vitit kalendarik, por edhe në periudhë zgjedhore, në asnjë nga zgjedhjet e përgjithshme apo vendore që janë mbajtur në vend që pas ndryshimit të regjimit diktatorial, nuk është bërë transparencë mbi financimet e subjekteve zgjedhore, edhe pse fushatat elektorale kanë spikatur si shumë

të shtrenjta, nga të dyja partitë kryesore. Ky fakt është evidentuar dhe në raportet e ODIHR/OSCE për zgjedhjet parlamentare 2005.

Transparency International (TI), në një raport të vitit 2009, i arritshëm në këtë link: http://www.transparency.org/news_room/latest_news/press_releases_nc/2009/2009_06_11_albania_elections, raporton nivelin e ulët të transparencës financiare të partive politike në Shqipëri.

Media shqiptare, përcjell deklaratimet zyrtare të TI, në lidhje me këtë argument: “Partitë politike në vend, vazhdojnë të çenojnë një nga detyrimet e tyre kryesore kushtetuese, bërjen publike të çdo lloj burimi financiar. Ato vazhdojnë të fshehin në mënyrë të vazhdueshme deklaratimin e burimeve të tyre private”.

Në analizën e TI ka rezultuar se “informaliteti, mungesa e transparencës dhe kuadrit ligjor, mungesa e kapaciteteve dhe mekanizmave të kontrollit në financimet kryesisht nga bizneset dhe subjektet private në favor të partive politike ka krijuar një terren të përshtatshëm për një nivel të lartë të korrupsionit politik”. TI sqaron në raportin e saj se: “Shoqëritë tregtare të cilat janë financueset më të mëdha nuk janë të interesuara të formalizojnë këto marrëdhënie dhe donacionet e tyre pasi në thelb kanë interesa të ngushta për të përfituar në proceset e prokurimeve, privatizimeve, sipërmarrjeve publike, etj. Ata kthehen kështu jo vetëm në partnerë në abuzimin me pushtetin por edhe influencues në vendimmarrje të rëndësishme politike, ekonomike dhe institucionale”, thuhet në njoftimin për shtyp, i cili vijon “Vetë partitë politike nuk kanë bërë ende asnjë përpjekje, për të ngritur kapacitete dhe për të shmangur vakuumin në struktura me qëllim auditimin e brendshëm të financave dhe kjo gjë vihet re pothuaj në të gjitha partitë politike në vend”.

Hapi më i rëndësishëm që është hedhur në këtë drejtim mbetet Kodi i ri Zgjedhor i miratuar me Ligjin Nr. 10019, datë 29.12.2008, me konsensusin e dy forcave kryesore politike në vend, Partia Demokratike e djathtë dhe Partia Socialiste e majtë.

Ky Kod rregullon për herë të parë në historinë e pluralizmit në Shqipëri,

aspektin financiar në lidhje me subjektet zgjedhore duke ndarë financimet publike nga ato jopublike. Por kjo vetëm në periudhë zgjedhore.

Ky rregullim ligjor nuk gjen asnjë truall të trashëguar transparence dhe këto janë zgjedhjet e para që reflektojnë këtë rregullim të ri ligjor dhe shkallën e zbatueshmërisë së tij.

Kodi Zgjedhor në fuqi legjitimon në nenin 1 se: ky Kod ka për qëllim caktimin e rregullave për përgatitjen, zhvillimin, administrimin, mbikëqyrjen, si dhe shpalljen e rezultatit të zgjedhjeve për në Kuvendin e Shqipërisë, për organet e qeverisjes vendore dhe referendumet.”

Në pikën e dytë të neni 1, pika d, përcakton si objekt rregullimi të këtij Kodi: “financimin e subjekteve zgjedhore”. Ky kod i njeh Komisionit Qendror Zgjedhor atributin ligjor: “Ushtron kontrollin mbi financimet e fushatës zgjedhore, në përputhje me këtë Kod”.

Neni 89 rregullon financimin e subjekteve zgjedhore nga fondet jopublike. Pika 1 e këtij neni përcakton: “Subjektet zgjedhore mund të marrin, për qëllime të fushatës së tyre zgjedhore, fonde vetëm nga persona fizikë ose juridikë vendas. Për qëllim të këtij Kodi, konsiderohet person fizik vendas edhe shtetasi shqiptar me banim jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.”

Në pikën 2 vendosen fondet limit të kontributeve që një donator privat mund t’i dhurojë subjektit zgjedhor: “Shuma që çdo person fizik ose juridik mund t’i japë një subjekti zgjedhor nuk mund të jetë më e madhe se 1 milion lekë ose kundërvlehtë në sende ose shërbime”.

Po në këtë nen në pikën 3 specifikohen kushtet përcaktuese që lejojnë apo ndalojnë donacionin: “Ndalohet dhënia e fondeve nga një person juridik apo çdo aksionar i tij nëse ndodhet në një nga kushtet e mëposhtme:

- a) ka përfituar fonde publike, kontrata publike apo koncesione në 2 vitet e fundit me vlerë mbi 10 milionë lekë;
- b) ushtron veprimtari në fushën e medias;
- c) ka qenë partner me fonde publike në projekte të ndryshme;
- ç) ka detyrime monetare ndaj Buxhetit të Shtetit ose ndaj çdo institucioni

publik. Ky detyrim nuk zbatohet nëse aksionari i zotëron këto aksione si rezultat i ofertës publike.”

Krahas këtij rregullimi gjeneralizues të nenit 89, neni 90 mbështet teknikisht bërjen e transparencës:

“1. Çdo subjekt zgjedhor duhet të regjistrojë në një regjistër të posaçëm, miratuar si model me vendim të KQZ-së, shumën e fondeve të përfituara për çdo person fizik ose juridik, si dhe të dhëna të tjera që lidhen me identifikimin qartë të dhuruesit. Në çastin e dhurimit, dhuruesi nënshkruan një deklaratë, ku zotohet se ai nuk ndodhet në një nga rrethanat e përcaktuara në nenin 89 të këtij Kodi dhe mban përgjegjësi personale për deklaram të rremë. Forma dhe përmbajtja e deklaratës miratohet nga KQZ-ja dhe është e detyrueshme për t’u nënshkruar në çdo rast dhurimi. Lista e personave që dhurojnë shuma jo më pak se 100 mijë lekë, si dhe vlera përkatëse duhet të bëhen kurdoherë publike.”

Pika 2 e po këtij neni formalizon mënyrën e aplikimit për donacionet që tejkalojnë shifrën e përcaktuar si limit-dysheme: “2. Dhurimi i fondeve jopublike me vlerë më të madhe se 100 mijë lekë duhet të bëhet vetëm në një llogari të posaçme të hapur në një bankë nga subjekti zgjedhor. Përgjegjësi i financës së subjektit zgjedhor, jo më vonë se tre ditë nga fillimi i fushatës zgjedhore, deklaron numrin e llogarisë bankare të hapur për këtë qëllim. Numri i llogarisë bankare për çdo subjekt politik publikohet në faqen zyrtare të KQZ-së.”

Pika 3 e të njëjtit nen përcakton limitin tavan të donacioneve: “3. Shpenzimi total që mund të kryejë një parti politike, përfshirë edhe kandidatët e tyre, për një fushatë zgjedhore nuk duhet të kalojë 10-fishin e shumës më të madhe që një subjekt zgjedhor ka marrë nga fondet publike, sipas nenit 87 të këtij Kodi. Çdo shpenzim i kryer për fushatën zgjedhore dokumentohet dhe kryhet duke respektuar legjislacionin tatimor në fuqi.”

Këto janë referencat ligjore, ku mbështetet monitorimi, ndërsa periudha paszgjedhore, përmes Auditimit me ekspertë kontabël të licensuar dhe të

zgjedhur me short nga KQZ, si e vetmja dritare e ligjshme për të bërë transparencë, shërbeu për të vlerësuar në mënyrë empirike zbatimin real të detyrimit ligjor, të subjekteve zgjedhore për transparencë financiare.

IV. INSTITUCIONET E MONITORUARA

Partia Socialiste e Shqipërisë
Partia Demokratike e Shqipërisë
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

V. DISA VLERËSIME MBI SHKALLËN E RESPEKTIMIT TË LIGJIT MBI TRANSPARENCËN FINANCIARE NGA SUBJEKTET POLITIKE NËPËRMJET MONITORIMIT

1. STANDARTI: Burimet financiare të partive, si dhe shpenzimet e tyre bëhen kurdoherë publike. (neni 9, Parime Themelore, Kushtetuta e Shqipërisë)

1.a Sipas këtij standarti kushtetues, situata paraqitet zhgënjyese, pasi ky detyrim ligjor deri tani ka mbetur formal dhe i pazbatuar në një kornizë të plotë. Subjektet politike deri përpara miratimit të Kodit të ri Zgjedhor janë mjaftuar me kontabilizimin e të ardhurave, duke shmangur transparencën mbi to.

Dy forcat kryesore politike në vend kanë shfaqur disponim të ulët për t'iu përgjigjur në mënyrë të detajuar pyetësorit të përgatitur, në drejtim të bërjes transparente të mekanizmave financiarë që aplikojnë si subjekte.

Partia Socialiste nuk i është përgjigjur pyetjeve të drejtpërdrejta për praktikën e menaxhimit të fondeve dhuratë nga donatorë korporativë apo individuale, po ashtu ka anashkaluar edhe pyetjet që kërkojnë informacion jo formal në lidhje me praktikën financiare të subjektit në tërësi.

Ky subjekt në përgjigjen e pyetësorit është mjaftuar me vlerësimin e rëndësisë së transparencës financiare të subjekteve zgjedhore në tërësi, duke e çmuar këtë si nevojë për vetë subjektin, institucionet dhe shoqërinë në

tërësi. Ky subjekt e sheh të mjaftueshme bërjen e transparencës vetëm në kohë zgjedhore dhe jo si praktikë të përhershme pune. Në përgjigjet e dhëna mungon informacioni për të dëshmuar materializimin e këtij vullneti.

Partia Demokratike e Shqipërisë, megjithë disponimin e plotë që ka shfaqur në komunikimet jo formale me realizuesit e këtij projekti, nuk e dorëzoi të plotësuar brenda afateve kohore të vëna në dispozicion pyetësorin e saj.

1.b Përmbyllja e procesit zgjedhor dhe procesit të Auditimit me ekspertë kontabël të licensuar, të zgjedhur me short nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, përforcon këtë konstatim të fazës së parë të projektit tonë, në fillim të fushatës zgjedhore.

Pasqyrat financiare të subjekteve politike të publikuara në raportet e Auditit, dëshmojnë hendekun e pakarpërcyeshëm që shkakton mungesa tërësore e transparencës financiare nga ana e subjekteve gjatë periudhës joelektorale.

Auditimi i deklarimeve financiare të subjekteve në periudhën 28 maj deri më 28 qershor, synon të çertifikojë pasqyrat financiare të subjekteve për anomali materiale. Ekspertët deklarohen në dijeni të mjaftueshme për të vlerësuar jo thjesht formalisht, por edhe thelbësisht deklaratimet financiare të subjekteve në këtë periudhë një mujore. Ekspertët e Auditit vlerësojnë se pasqyrimi i të ardhurave dhe shpenzimeve është i vërtetë dhe i sinqertë, për secilën nga dy subjektet kryesore politike, objekt monitorimi të këtij projekti.

Nga gjetjet tona empirike na rezulton se pasqyrat financiare të subjekteve formalisht janë të rregullta. Por nuk përbëjnë një bazë të mjaftueshme për të dëshmuar sinqeritetin e këtyre deklarimeve. Ky deduksion rrjedh nga dy premisa kryesore: Burimi i të ardhurave dhe imazhi i secilës forcë politike në fushatë i përballur me shpenzimet e deklaruara.

1. Nga pasqyrat financiare që publikohen në raport, rezulton se të ardhurat e subjekteve për këtë fushatë zgjedhore burojnë nga 4 burime, që janë;

Buxheti i Shtetit, Burimet e vetë subjektit politik, Sponsorizimet, përfshi edhe ato në natyrë, si edhe Kuotat e anëtarësisë.

Duke analizuar këto burime të ardhurash bie në sy fondi i siguruar nga burimet e vetë subjektit.

Partia Demokratike ka deklaruar si gjendje të ardhurash në këtë fushatë rreth 150 milionë lekë, nga të cilat Burime të vetat, pra të ardhura pa një origjinë të deklaruar, janë rreth 50 milionë lekë, 30 % e totalit të të ardhurave.

Partia Socialiste ka deklaruar në total rreth 93.6 milion lekë, nga të cilat Burime të vetat janë afërsisht 73 milion lekë, pra 80% e krejt të ardhurave.

Këto para janë pa një origjinë të deklaruar, sepse detyrimi për transparencë sipas legjislacionit shqiptar në fuqi, prek vetëm periudhën zgjedhore.

Financimi i subjekteve politike jashtë periudhës elektorale përbën një burim të rëndësishëm financimi të tyre edhe për fushatat zgjedhore. Nëse fushatat elektorale do të konsiderohen një kulminacion i veprimtarisë politike të subjekteve zgjedhore, interesi publik për garantimin e transparencës në fazat para dhe gjatë elektorale kërkon një mbikqyrje të vazhdueshme të rrugëve të financimit të subjekteve politike, të cilat mund të grumbullojnë të ardhura gjatë viteve jozgjedhore për t'i përdorur në zgjedhje. Dhe këtu sinqeriteti i lexuar nga Auditi mbetet për t'u kuptuar...

2. Dy forcat kryesore spikatën në këto zgjedhje me fushata të shtrenjta në imazh dhe me shpenzime të ndjeshme në produkte promovionale. Intensiteti i fushatës ishte i tillë që nuk lë vend për dilema se kostot e fushatës kanë qenë të larta. Gjithsesi, brenda logjikës së blerjes me shumicë të produkteve çmimet njësi mund të pranohet të jenë më të ulta se çmimet e mbledhura në tregun e shërbimeve të këtij lloji. Por arsytimi përkatës mund dhe duhet të ishte shoqëruar në rastin e auditit me praktikën e prokurimit të zbatuar, dmth vlerësimin të më shumë se një oferte që përfaqëson Shitësin e shërbimit për partitë e përfshira në këtë analizë. Edhe ky segment i punës përbën në themel një element të rëndësishëm të fushatës.

Deklarimi i çmimit zë për zë për çdo produkt në përputhje me sasinë e porositur dhe mënyra e realizimit të tij zbardhin në themel dy elemente kryesore që përfshijnë Donacionet e fshehta.

Kështu, në rastin e blerjes së konsulencës për zgjedhjet Partia Socialiste ka paguar vetëm 7.960.900 lekë (afro 65,000 Euro) ndaj një studioje që drejtohet nga një titullar shumë i njohur i marketingut politik në New York, USA.

Partia Demokratike raporton se ka shpenzuar për një agjensi konsulence Irlandeze rreth 44,882,548 Lek (afro 400 mijë Euro ose rreth 7 herë më tepër se PS). Deklarimi i PD-së për këtë çmim është më i besueshëm, po të kihet parasysh se segmenti i konsulencës së PD-së ka përfshirë të gjithë periudhën e fushatës. Nëse PS ka blerë tek Arthur J. Finkelsteing Associates Inc. S.A. vetëm Strategjinë e fushatës ose vetëm dy Fjalime të Kryetarit të partisë (në hapje dhe mbyllje të fushatës), atëherë kjo blerje do të ishte blerje produkti konsulence dhe jo blerje e zërit Konsulencë. Kujtojmë këtu faktin se gjatë fushatës së mëparshme, PS kishte angazhuar një konsulent lobingu me një kontratë 1 vjeçare që kushtonte 40,000 dollarë në muaj, kontratë e cila u zbardh nga mediat. Dhe konsulenti ishte individual dhe jo një shoqëri (që gjithsesi tarifon së paku 35-60% më shtrenjtë për konsulent se një individ). Detajimi më i mirë i prokurimit të realizuar bëhet në këtë rast thelbësor për të kuptuar transparencën e ofruar.

Sjellja klienteliste është po ashtu një formë e deformimit të tregut në tërësi, si pasojë dytësore. Në këtë drejtim mund të nënvizohet fakti se aq sa PD deklaroi se ka shpenzuar në qendër për hapësirë publicitare me të gjitha mjetet e komunikimit publik, PS ka paguar vetëm Top Channel, duke dhënë qartësisht një sjellje klienteliste në tregun e mediave.

PD nuk i përgjigjet kaq në detaje këtij raportimi, duke mos dhënë zëra shpenzimesh.

Mosndarja e shpenzimeve në njësi produkti krijon gjithashtu një vështirësi të pakapërcyeshme në leximin e bilancit të shpenzimeve. Kështu, çmimi i marrë për spot TV, çmimi i marrë për spot radio, çmimi njësi për city-light, çmimi i posterave, banderolave qytetase, etj. bëjnë diferencën në këtë analizë.

Partia Demokratike deklaroi se ka shpenzuar për koncerte 1,800,000

Lek nga qendra dhe 3,241,860 Lek nga degët. Totali i koncerteve arrin në 5,041,860 Lek. Kjo vlerë nëse krahasohet me deklarinimet¹ e këngëtarëve, duke përfshirë ELITA 5 – që ka thënë në media të ketë marrë në total 400,000 Euro për formulimin e këngës së fushatës, Çiljeta Xhilaga – e cila ka deklaruar se paguhet 130,000 Lek për çdo koncert, etj. rezultojnë shumë e dyshimtë. Përveç Elita 5 në koncertet e PD-së kanë kënduar 7 këngëtarë. Në kostot e koncertit hyn edhe skenografia dhe skena, mbi të cilën realizohet mitingu. Gjithashtu kjo përfshin edhe shërbimin audio dhe shërbimin e ndriçimit për koncertet/tubimet e mbrëmjes. A qëndron dot kjo shifër brenda parametrave të sinqeritetit që nënvizojnë Auditorët, apo duhet marrë për bazë sinqeriteti i këngëtarëve? Çmimet e produkteve janë tërësisht evazivë dhe të pagjyqeshëm, ndaj vlerësimi i tyre i detajuar do të prodhonte një premisë të gabuar analize. Këtu mund të vlerësohet mbi një supozim çmimi i reklamës out-door, i cili gjithsesi ka qenë më i lexueshëm se të tjerët.

PS deklaroi se ka harxhuar për City lights dhe tabela 11.142.751 lekë. Me një çmim mesatar të city-light 25,000 Lek, PS ka mundur të blejë rreth 445 city lights dhe tabela qytetase. Nga kjo vlerë mund të zbritet një segment që llogarisim të barabartë me afro 45 city lights, që janë zëvendësuar me 15-20 tabela të formatit të madh (large format 8 x 4m).

Nga 400 city lights për 36 qytete, mesatarja që PS i bie të ketë afishuar është 12 copë për qytet. Kjo shifër është krejtësisht e papranueshme për një njeri që ka jetuar në Shqipëri gjatë fushatës elektorale.

Më keq akoma, PD deklaroi se për këtë zë nën emrin “Billboard” ka shpenzuar 1,641,094 Lekë. Me të njëjtën vlerë krahasuese, PD i bie të ketë blerë vetëm 65 copë, mesatarisht 2 city-lights për qytet.

Mbetet për t’u ndricuar këtu edhe njëherë çështja e sinqeritetit të partive siç nënvizojnë auditorët.

¹<http://www.zerikosovar.com/Zgjedhjet-Shqiperi-2009/milionat-e-kengetareve-ne-fushaten-e-pd-aventurat-ne-furgonin-qe-pershkon-kryq-e-terthor-shqiperine.html>

Në lidhje me posterat e prodhuar, PD deklaroi shifrën 5,510,000 Lek afro 50,000 Euro të shpenzuar brenda dhe jashtë vendit në porosi prodhimi. PS thotë se ka paguar për postera vetëm 4,000 Euro, të derdhura nga një donator në një tipografi jashtë vendit, në Kosovë. Çmimi minimal i një posteri A1 – formati më i vogël i përdorur në fushatë, me 4 ngjyra, letër lustër 200 gr (kualiteti më i ulët i letrës), është 28 – 40 Lekë. Kjo vlen kur posteri është unik dhe prodhohet me të njëjtën lastër.

Nëse marrim një çmim mesatar 35 Lek ose 0,25 Euro, atëherë PS i bie të ketë prodhuar dhe konsumuar në fushatë 16,000 postera. Nëse diversifikohet imazhi i përdorur në fushatë dmth më shumë se 1 poster, kjo shifër maksimalisht arrin në 10,000 postera. Mesatarja e posterave të nevojshëm për qytete të mëdha si Tirana apo Durrësi është 20 - 30,000 copë.

PD mund të deklarojë qartësisht se me shifrën e raportuar ka prodhuar mes 120 – 150,000 postera. Edhe ky deklaram nisur nga imazhi viziv i fushatës është i paplotë dhe numri i posterave të përdorur është të paktën dy herë më i lartë.

Partitë deklarojnë se kanë shpenzuar për transportin e tyre një volum karburanti, që gjithashtu në ndonjë rast bie të jetë pjesë e donacioneve të përfituara prej tyre. Kështu PS ka marrë si donacion 9,500 Litra karburant (6,500 naftë dhe 3,000 litra benzinë). **Me një mesatare konsumi 9 litra për 100 km, PS ka arritur të bëjë gjithsej 1,000 km rrugë në një muaj fushatë efektive. Vetëm një udhëtim nga Tirana në Sarandë dhe kthim bën 600 km.**

PD deklaroi në qendër se ka konsumuar 1,844,200 Lek karburante dhe në degët 7,957,152 Lek lëndë djegëse. Në total kjo vlerë arrin 9,801, 352 Lek karburante. E pjestuar me një çmim preferencial 120 Lek /litër, ky total arrin në 81,677 litra, ose ndryshe në mëse 90,000 km të mbështetur me karburant për fushatë. Kjo shifër është 90 herë më e lartë se ajo e deklaruar nga PS.

E njëjta llogjikë vlen edhe për zërat e tjerë të raportuar.

Mbetet e pasqaruar në këtë raport çështja se me çfarë të ardhurash PS

mbështeti parafushtën e vullnetarëve të saj, e cila përfshiu shumicën e qyteteve të vendit dhe u shpërfaq me një volum të rëndësishëm produktesh promocionale. Megjithëkëtë protagonizëm aktiv në periudhën jo elektorale, ky subjekt deklaroi rreth 73 milion lekë të mbartura në vite!? Ky fakt e bën mëse të domosdoshëm nevojën e audimit permanent të të ardhurave të partive, për të kuptuar jo vetëm burimet e tyre të brendshme, por krejt skemën e funksionimit të tyre në kohë.

2. STANDARDI: Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ushtron kontrollin mbi financimet e fushatës zgjedhore, në përputhje me këtë Kod (neni 21 i Kodit Zgjedhor).

2.a Komisioni Qendror Zgjedhor ka bashkëpunuar në mënyrë shumë korrekte në plotësimin e pyetësorit të adresuar, duke shfaqur vullnetin e plotë për të respektuar kornizën ligjore që rregullon detyrimet e subjekteve zgjedhore për transparencë të financimeve që sigurojnë nga donatorë publikë dhe jopublikë.

Ndryshimet e Kodit Zgjedhor, rregullojnë për herë të parë në historinë e pluralizmit në Shqipëri çështjen e financimit të subjekteve zgjedhore, duke përfshirë ato publike dhe private, kufizimet si dhe procedurat për monitorimin dhe raportimin.

KQZ raporton se asnjë nga subjektet politike nuk ka prezantuar pranë KQZ-së zyrtarisht kërkesën për shpjegime apo detaje për paqartësi në lidhje me këto detyrime ligjore që burojnë prej Kodit Zgjedhor.

2.b Komisioni Qendror Zgjedhor në vijim të fushatës elektorale ka përmbushur detyrimet që i njej ligji, konkretisht Kodi Zgjedhor, neni 90, duke miratuar regjistrin e posaçëm për regjistrimin e fondeve të përfituara prej subjektit zgjedhor nga çdo person fizik dhe juridik dhe të dhëna të tjera që lidhen me identifikimin qartë të dhuruesit. Në çastin e dhurimit, dhuruesi nënshkruan një deklaratë, ku zotohet se ai nuk ndodhet në një nga rrethanat e përcaktuara në nenin 89 të Kodit dhe mban përgjegjësi personale për

deklarim të rremë. Forma dhe përmbajtja e deklaratës është miratuar po ashtu nga KQZ-ja. Ky Kod i njeh Komisionit Qendror Zgjedhor atributin ligjor: “Ushton kontrollin mbi financimet e fushatës zgjedhore, në përputhje me këtë Kod”.

Në përmbushje të këtij detyrimi KQZ e ushtroi tagrin e vet ligjor me paraqitjen e relacionit mbi raportin e Auditit të paraqitur nga ekspertët kontabël të licensuar dhe të zgjedhur me short nga KQZ për të vlerësuar, për të parën herë në historinë e pluralizmit në Shqipëri, transparencën financiare të subjekteve politike në zgjedhjet e 28 qershorit 2009.

Me vendim Nr.605 datë 14.09.2009, KQZ ka vendosur: “Të miratojë rezultatin e shortit dhe të emërojë ekspertët kontabël të cilët do të auditojnë subjektet zgjedhore për fondet e përfituara dhe të shpenzuara për fushatën zgjedhore, zgjedhjet e përgjithshme parlamentare të datës 28 qershor. Relacioni i publikuar prej saj është mbështetur në të dhënat e ofruara nga ekspertët kontabël, duke analizuar, në mënyrë të detajuar respektimin e kërkesave të parashikuara në Kodin Zgjedhor nga ana e Partive Politike gjatë fushatës zgjedhore. **Raporti i Auditit dhe Relacioni i KQZ nuk kanë bërë asnjë hetim që kapërcen deklaratimet e vetë subjekteve si për të ardhurat ashtu edhe në zërin e shpenzimeve. Ky Auditim është akses i vetëm që ligji njeh për të bërë transparencë mbi deklaratimet financiare të subjekteve politike për fushatën zgjedhore 2009.**

3. STANDARDI: 1. Subjektet zgjedhore mund të marrin, për qëllime të fushatës së tyre zgjedhore, fonde vetëm nga persona fizikë ose juridikë vendas.

2. Shuma që çdo person fizik ose juridik mund t’i japë një subjekti zgjedhor nuk mund të jetë më e madhe se 1 milion lekë ose kundërvlefëta në sende ose shërbime. (Neni 89/ 1, 2, Kodi Zgjedhor).

3.1 Në fazën e parë të monitorimit të kryer prej nesh përmes pyetësorëve, Partia Socialiste deklaroi se e njeh këtë rregullim ligjor dhe e gjen atë realist.

Partia Demokratike nuk ka dhënë përgjigje, duke mos e plotësuar pyetësonin.

3.2 Në mbyllje të procesit zgjedhor, Auditimi zyrtar shprehet duke iu referuar deklarimeve të subjekteve se subjektet politike kanë respektuar ligjin.

Të dhënat e deklaruara nga subjektet ruajnë përputhshmërinë me kuadrin ligjor si të gjitha subjektet juridike dhe fizike që operojnë në vend, por kjo nuk shmang praktikën informale, që vihen re edhe tek operatorët ekonomikë. Ligji në këtë rast duke i kushtëzuar donacionet me konfliktin e interesit, gjykojmë se nxit financimet e padukshme ndaj subjekteve politike.

Këto financime të padukshme janë më të prirura që të vijnë nga subjekte tregtare private, që vetë ligji, përmes klauzolës së konfliktit të interesit i pengon të përfshihen në donacione direkte në favor të subjekteve politike. Kjo klauzolë shtyn drejt veprimeve klandestine palët e interesuara që të ndërveprojnë në periudha elektorale dhe që mund të shkëmbejnë favore jo legjitime pas përmbylljes me sukses të procesit të sponsorizuar zgjedhor.

Krijimi i transparencës pa kushte për këto sponsorizime dhe forcimi i njëkohshëm i mbikqyrjes së proceseve të prokurimit publik, për të shmangur favorizimet me sfond elektorale dhe krimin ekonomik që ai mund të burojë, do të përmirësonin nivelin e respektimit të ligjit nga ana e të gjitha palëve në proces, duke rritur shkallën e transparencës zgjedhore dhe performancën qeverisëse të cilësdo administratë.

Kjo qasje sjell më në shprehje interesin publik që partitë garantojnë se do të mbrojnë pas përmbylljes me sukses të procesit zgjedhor. Gjithashtu kjo qasje i detyron partitë të jenë më të përgjegjshme ndaj mjedisit ekonomik kombëtar, duke ndihmuar njëkohshëm grupet e interesit të investohen në politikë-bërje.

Ky bashkëpunim transparent në të njëjtën kohë largon partitë nga pozitën populiste dhe ideologjike dhe i bën politikat e tyre më të lexueshme në nivel publik.

4. STANDARDI: 1. Çdo subjekt zgjedhor duhet të regjistrojë në një regjistër të posaçëm, miratuar si model me vendim të KQZ-së, shumën e fondeve të përfituara për çdo person fizik ose juridik, si dhe të dhëna të tjera që lidhen me identifikimin e qartë të dhuruesit. Forma dhe përmbajtja e deklaratës miratohet nga KQZ-ja dhe është e detyrueshme për t'u nënshkruar në çdo rast dhurimi. Lista e personave që dhurojnë shuma jo më pak se 100 mijë lekë, si dhe vlera përkatëse duhet të bëhen kurdoherë publike (Neni 90, Kodi Zgjedhor).

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka miratuar brenda afateve ligjore modelin e regjistrimit të posaçëm që duhet të përdorin subjektet zgjedhore për regjistrimin e fondeve të përfituara për fushatën zgjedhore, për zgjedhjet për Kuvendin 2009. KQZ po ashtu ka miratuar modelin e deklaratës që duhet të nënshkruajnë dhuruesit në çastin e dhurimit të fondeve për llogari të subjektit zgjedhor.

4.1 Në fazën e parë të monitorimit Partia Socialiste në përgjigjet e dhëna në pyetësor ka shprehur angazhim për përmbushjen e këtij detyrimi. Partia Socialiste përgjigjet se ekziston struktura financiare që rregullon këtë proces. Kryefinancieri është i zgjedhur nga kryesia e partisë që drejton dhe organizon procesin financiar dhe bën transparencën pranë KQZ dhe Organeve Kushtetuese. Ka një strukturë me financier dhe llogaritar, arkëtar.

Partia Demokratike nuk e ka dorëzuar pyetësorin.

4.2 Në fazën e dytë të projektit, qasjet e secilës forcë në raport me detyrimet përkatëse ligjore formalisht i respektojnë këto klauzola ligjore, por në një shtrirje të kufizuar kohore, respektivisht muajin elektoral. Ekspertët e auditit vënë në pah se donacionet e ardhura pranë subjekteve politike përpara këtij afati nuk kanë ndjekur këtë praktikë, sepse nuk është kërkesë ligjore. Ky ngërç që dobëson dukshëm performancën e transparencës së subjekteve për periudhën zgjedhore, do të zgjidhej me vendosjen e detyrimit ligjor për transparencë konstante të subjekteve edhe jashtë periudhës elektorale.

Ky rekomandim përforcohet edhe nga ndjeshmëria e lartë që kanë shfaqur dy subjektet kryesore në vend në fazën e parë të monitorimit, por edhe më gjerë në deklaratimet mediatike, ku e konsiderojnë të mjaftueshme transparencën e financimeve të tyre vetëm në periudhë elektorale. Praktika e deritanishme në Shqipëri nuk njeh asnjë rast të vetëdeklarimit të financimeve nga subjektet politike megjithë trysinë publike për të bërë transparencë të fondeve që mundësojnë fushata shumë të shtrenjta elektorale.

5. STANDARDI: Dhurimi i fondeve jopublike me vlerë më të madhe se 100 mijë lekë duhet të bëhet vetëm në një llogari të posaçme të hapur në një bankë nga subjekti zgjedhor. Përgjegjësi i financës së subjektit zgjedhor, jo më vonë se tre ditë nga fillimi i fushatës zgjedhore, deklaron numrin e llogarisë bankare të hapur për këtë qëllim. Numri i llogarisë bankare për çdo subjekt politik publikohet në faqen zyrtare të KQZ-së (neni 90/2, Kodi Zgjedhor).

Në fazën e parë të monitorimit Partia Socialiste e Shqipërisë i ka publikuar në faqen e saj të internetit www.ps.al, numrat e llogarive bankare që janë në dispozicion të donatorëve jopublikë që dëshirojnë të dhurojnë fonde për këtë subjekt politik.

Partia Demokratike nuk e ka dorëzuar pyetësin, por i ka bërë ato publike.

KQZ raportoi në pyetësor se deri në momentin e dorëzimit të pyetësit subjektet politike pjesëmarrëse në fushatë nuk kanë depozituar këto llogari bankare pranë KQZ-së. KQZ po ashtu raportoi se do t'ju drejtojë apel publik subjekteve që marrin pjesë në zgjedhje të përmbushin dhe këtë detyrim që përcakton ligji. Kodi Zgjedhor nuk parashikon marrje masash në rast vonesash lidhur me këtë çështje. Kjo është një çështje që del e nevojshme të rregullohet në ligj, për ta bërë më efikas kontrollin e KQZ në përmbushje të këtij detyrimi.

KQZ bëri me dije se nuk ka asnjë pretendim nga ana e subjekteve politike, për pamundësinë e zbatimit të kuadrit ligjor përkatës i cili rregullon

transparencën e financimeve të subjekteve zgjedhore. Në këtë rast, ekspertët e Auditit raportojnë donacione që janë bërë përpara fillimit të fushatës zgjedhore dhe më pas sipas raportimit të vetë subjekteve janë zhvendosur nga arka e subjektit në bankë. Zgjerimi i shtrirjes kohore të detyrimit për transparencë përgjatë gjithë vitit, do të rriste ndjeshëm besueshmërinë e subjekteve përballë publikut, po aq edhe të vlerësimeve të auditit.

Në çdo rast të shkeljes së dispozitave të Kodit Zgjedhor, neni 173 i Kodit, parashikon ndëshkimin me gjobë nga 50 000 deri në 100 000 lekë për përgjegjësit e financës të partisë politike, duke shmangur një penalizim individual. Në kushtet e një praktike shumë të dobët të rregullimit ligjor të transparencës financiare të subjekteve politike, del i nevojshëm një penalizim më i fortë në rastet e shkeljes së ligjit, i tillë që njeh përgjegjësitë individuale dhe tejkalon thjesht kostot financiare, të cilat lehtësisht mund të mbulohen nga subjekti në tërësi. Ky penalizim ndaj subjektit në vlerë monetare duhet të përfaqësojë një shumëfish të devijimit financiar të kryer në raportimin e bilancit nga vetë subjekti, ndërsa duhet të konsiderojë ndaj punonjësit të financës dhe kontabilistit të certifikuar një përgjegjësi penale individuale nën akuzën e krimit ekonomik me pasoja të rënda shoqërore dhe të korrupsionit pasiv.

6. STANDARDI: Shpenzimi total që mund të kryejë një parti politike, përfshirë edhe kandidatët e tyre, për një fushatë zgjedhore nuk duhet të kalojë 10-fishin e shumës më të madhe që një subjekt zgjedhor ka marrë nga fondet publike, sipas nenit 87 të këtij Kodi. Çdo shpenzim i kryer për fushatën zgjedhore dokumentohet dhe kryhet duke respektuar legjislacionin tatimor në fuqi (Neni 90/3, Kodi Zgjedhor).

Në fazën e parë të monitorimit Partia Socialiste e Shqipërisë e konsideron realist këtë kufizim që përcakton ligji.

Partia Demokratike nuk e ka dorëzuar pyetësin.

Pas përmbylljes së procesit zgjedhor, raporti i Auditit vlerëson respektimin e këtij kufizimi ligjor, në vlerësim të dokumentacionit të ofruar zyrtarisht nga vetë subjektet.

Gjetjet tona empirike e dyshojnë këtë konstatim, nisur nga segmentimi kohor i transparencës, informaliteti i lartë në ekonominë shqiptare dhe nga performanca e këtyre subjekteve në fushatë, vlerësuar me çmimet e tregut. Nga të dhënat empirike të grumbulluara procesi i financimit të partive realizohet në mënyrë të pavarur si nga qendra ashtu edhe nga degët e subjekteve politike. Pasqyrat financiare të partive janë në përgjithësi bilance të veprimtarisë ekonomike të degëve qendrore të tyre, ku shpenzimet për financimin e veprimtarisë së degëve lokale pasqyrohen vetëm si kosto operative në zërin e shpenzimeve. Në këto bilance të ardhurat e mbledhura nga degët përgjithësisht mungojnë, pasi ato destinohen për veprimtaritë lokale në periudhën jashtë zgjedhore, e cila nuk mbikqyret nga ligji për transparencën, në përputhje me Kodin Zgjedhor.

Në shumë veprimtari elektorale këto para' shndërrohen në shërbime, pa u kontabilizuar dot si të ardhura elektorale apo financime të sponsorizuara.

Për sa më lart, një ndihmë të veçantë jep edhe mosdeklarimi i shpenzimeve nga partitë në përputhje me një bilanc të detajuar, i cili duhet të shpjegojë me zëra adresimet e kryera përmes sponsorizimeve apo financimeve të tjera nga jashtë. Një audit i detajuar dhe i certifikuar, për çdo vit elektorale ose jo, do të ndihmonte në ruajtjen e barazisë dhe rritjen e kredibilitetit, i cili në periudhën zgjedhore shndërrohet në besueshmëri për rezultatin zgjedhor. Ky audit do të rehabilitonte kredibilitetin e cënuar që subjektet ushqejnë ndaj njëri-tjetrit. Që vetë subjektet politike të njihen më këtë pasqyrë financiare të njëra – tjetrës, duhet që ajo të jetë publike dhe jo të administrohet vetëm nga organet tatimore.

VI. PËRFUNDIME

Kjo është përvoja e parë në nivel legjislativ për rregullimin e marrëdhënieve financiare të subjekteve zgjedhore, e cila edhe pse e limituar në periudhë zgjedhore, ka shansin të shtrojë një rrugë të re komunikimi ndërinstitucional mes subjekteve dhe shtetit, po aq sa edhe në rrafshin më të gjerë shoqëror, për të formësuar një kulturë të re sjelljeje, veprimi dhe pritshmëri publike në Shqipëri.

Subjektet politike në Shqipëri për herë të parë në historinë e pluralizmit në vend i janë nënshtruar një auditimi të burimeve financiare të fushatës elektorale dhe shpenzimeve të kryera. Ky auditim është bërë mbi kontroll rastësor të dokumentacionit, sipas Standarteve Ndërkombëtare të Auditimit.

Raporti i KQZ saktëson se në asnjë rast nuk janë bërë kërkime shtesë në lidhje me fonde të përfituara dhe të shpenzuara nga subjektet politike.

Në mbyllje të këtij procesi monitorimi vërehet se:

Subjektet politike në linja kryesore kanë respektuar detyrimet ligjore në lidhje me transparencën financiare në përputhje me kërkesat e parashikuara në Kodin e ri Zgjedhor, duke dokumentuar në tërësi financimet e deklaruara të marra si donacion gjatë periudhës zgjedhore, por me një background jo transparent të fondeve të vetë subjektit, si edhe deklarime të padetajuara të shpenzimeve të kryera prej tyre .

Kjo gjetje prin drejt disa konkluzionesh të rëndësishme:

1 – Financimi i subjekteve politike jashtë periudhës elektorale përbën një burim të rëndësishëm financimi të tyre edhe për fushatat zgjedhore, ndërsa ky aspekt nuk është subjekt i rregullimit ligjor në Ligjin për Partitë Politike.

2 – Nga të dhënat empirike të grumbulluara procesi i financimit të partive realizohet në mënyrë të pavarur si nga qendra ashtu edhe nga degët e subjekteve politike. Pasqyrat financiare të partive janë në përgjithësi bilance të veprimitarisë ekonomike të degëve qendrore të tyre, ku shpenzimet për financimin e veprimitarisë së degëve lokale pasqyrohen vetëm si kosto op-

erative në zërin e shpenzimeve.

Në shumë veprimtari elektorale paratë e mbledhura nga degët shndërrohen në shërbime, pa u kontabilizuar dot si të ardhura elektorale apo financime të sponsorizuara.

3 - Për sa më lart, një ndihmë të veçantë jep edhe mosdeklarimi i shpenzimeve nga partitë në përputhje me një bilanc të detajuar, ku të deklarohen me zëra të vecantë çmimet për njësi dhe sasi të përkatëse të blera.

4 - Gjetjet empirike dëshmojnë se partitë politike janë në gjendje të përfitojnë shërbime në natyrë, të cilat falë intensitetit të fushatës zgjedhore, bëhen të rëndësishme në vlerë dhe mbesin të padeklaruar dhe të pallogaritshme në nivelin kontabël edhe nga kontrolli i auditit. Nëse një parti merr në natyrë vetëm shpenzimet e fonisë, nga një mesatare tubimesh elektorale prej 100 eventesh, me një çmim mesatar 400 euro, përfitimi i një partie do të arrijë 40 mijë euro, ose rreth 6 milion lekë të reja, vlerë e krahasueshme me totalin e donacioneve të deklaruar edhe nga parti të mëdha.

5 – Këto financime të padukshme janë më të prirura që të vijnë nga subjekte tregtare private, që vetë ligji, përmes klauzolës së konfliktit të interesit i pengon të përfshihen në donacione direkte në favor të subjekteve politike. Kjo klauzolë shtyn drejt veprimeve klandestine palët e interesuara që të ndërveprojnë në periudha elektorale dhe që mund të shkëmbejnë favore jo legjitime pas përmbylljes me sukses të procesit të sponsorizuar zgjedhor.

6 – Në çdo rast të shkeljes së dispozitave të Kodit Zgjedhor, neni 173, i Kodit parashikon ndëshkimin me gjobë nga 50 000 deri në 100 000 lekë për përgjegjësit e financës të partisë politike, duke shmangur një penalizim individual, ç'ka zbeh protagonizmin e tyre profesional dhe lehtëson praktikën informale në jetën ekonomike të subjekteve politike.

VII. REKOMANDIME

1. Nëse fushatat elektorale do të konsiderohen një kulminacion i veprimtarisë politike të subjekteve zgjedhore, interesi publik për garantimin e transparencës në fazat para dhe gjatë elektorale kërkon një mbikqyrje të vazhdueshme të rrugëve të financimit të subjekteve politike, të cilat mund të grumbullojnë të ardhura gjatë viteve jozgjedhore për t'i përdorur në zgjedhje.

2. Një audit i detajuar dhe i çertifikuar, për çdo vit elektorale ose jo, do të ndihmonte në ruajtjen e barazisë dhe rritjen e kredibilitetit, i cili në periudhën zgjedhore shndërrohet në besueshmëri për rezultatin zgjedhor. Ky audit do të rehabilitonte kredibilitetin e cënuar që subjektet ushqejnë ndaj njëri-tjetrit.

3. Që vetë subjektet politike të njihen më këtë pasqyrë financiare të njëra – tjetres, duhet që ajo të jetë publike dhe jo të administrohet vetëm nga organet tatimore.

4. Krijimi i transparencës pa kushte – duke hequr klauzolën ligjore të konfliktit të interesi - për sponsorizimet jopublike të subjekteve politike dhe forcimi i njëkohshëm i mbikqyrjes së proceseve të prokurimit publik, për të shmangur favorizimet me sfond elektorale dhe krimin ekonomik që ai mund të burojë, do të përmirësonin nivelin e respektimit të ligjit nga ana e të gjitha palëve në proces, duke rritur shkallën e transparencës zgjedhore dhe performancën qeverisëse të cilësdo administratë.

Kjo qasje sjell më në shprehje interesin publik që partitë garantojnë se do të mbrojnë pas përmbylljes me sukses të procesit zgjedhor. Gjithashtu kjo qasje i detyron partitë të jenë më të përgjegjshme ndaj mjedisit ekonomik kombëtar, duke ndihmuar njëkohshëm grupet e interesit të investohen në politikë-bërje.

Ky bashkëpunim transparent në të njëjtën kohë largon partitë nga pozitat populiste dhe ideologjike dhe i bën politikatat e tyre më të lexueshme në nivel publik.

5. Në kushtet e një praktike shumë të dobët të rregullimit ligjor të transparencës financiare të subjekteve politike, del i nevojshëm një penalizim

më i fortë në rastet e shkeljes së ligjit, i tillë që njeh përgjegjësitë individuale dhe tejkalon thjesht kostot financiare, të cilat lehtësisht mund të mbulohen nga subjekti në tërësi.

Ky penalizim ndaj subjektit në vlerë monetare duhet të përfaqësojë një shumëfish të devijimit financiar të kryer në raportimin e bilancit nga vetë subjekti, ndërsa duhet të konsiderojë ndaj punonjësit të financës dhe kontabilistit të certifikuar një përgjegjësi penale individuale nën akuzën e krimit ekonomik me pasoja të rënda shoqërore dhe të korrupsionit pasiv.

ANEX 1

QENDRA E STUDIMEVE PARLAMENTARE

Projekt: Monitorimi i zbatimit të detyrimeve ligjore prej subjekteve zgjedhore në lidhje me financimin e këtyre subjekteve gjatë zgjedhjeve parlamentare të vitit 2009.

Pyetësor:

Subjekti: Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve

Çështje për hulumtim

1- Ligje, akte nënligjore apo rregullore që përcaktojnë detyrimet ligjore të subjekteve zgjedhore në lidhje me financimet që ato marrin (publike dhe jopublike)

Cilat janë ligjet apo aktet nënligjore që rregullojnë ligjshmërinë e financimeve të partive politike, të cilave ju i referoheni, në përmbushje të detyrimit ligjor për kontrollin mbi financimet e tyre?

Kodi Zgjedhor trajton me detaje këtë moment, në pjesën e VII të tij “Financimi i Zgjedhjeve dhe i Fushatës”. Nenet 86, 87, 88, 89, 90, 91 dhe 92 përbëjnë një kuadër të plotë ligjor, si mbi financimet e partive politike nga fondet publike, fondet jopublike, por edhe për auditimin e fondeve dhe shpenzimeve të fushatës zgjedhore. Bazuar në këtë kuadër ligjor, Komisioni

Qëndor i Zgjedhjeve nxjerr udhëzime apo merr dhe vendime për secilën nga rastet respektive.

Sa jeni vënë në dijeni Ju si institucion nga subjektet politike për paqartësi të tyre në këtë drejtim?

Asnjë nga subjektet politike nuk ka prezantuar pranë KQZ-së zyrtarisht kërkesën për shpjegime apo detaje për paqartësi në lidhje me këto detyrime ligjore që burojnë prej Kodit Zgjedhor.

E vlerësoni të mjaftueshëm detyrimin për transparencë vetëm gjatë periudhës zgjedhore apo e gjykoni të nevojshëm në mënyrë permanente? Pse?

KQZ është një institucion ekzekutues dhe nuk mund të ketë një qëndrim lidhur me këtë pyetje. Është detyrë dhe kompetencë e ligjvënësit të përcaktojë kuadrin ligjor për zbatim.

2- Mekanizmat funksionalë për zbatimin e ligjit të transparencës.

A ekzistojnë struktura funksionale pranë Institucionit tuaj që mundësojnë rregullimin financiar të procesit zgjedhor nga pikëpamja e respektimit të ligjshmërisë prej subjekteve zgjedhore? Nëse po, cilat janë ato?

Kodi Zgjedhor në fuqi, në nenin 91 përcakton qartë detyrimet e KQZ-së por edhe të subjekteve politike lidhur me këtë çështje. Ndërkohë që neni 92 shpjegon qartë mënyrën e përzgjedhjes së ekspertëve kontabël për auditimin e subjekteve politikë.

A sjell nevojën për ngritjen e strukturave të reja të posaçme Kodi i ri Elektorale dhe detyrimet që burojnë prej tij? Nëse po, cilat janë? Nëse jo, a e përballojnë strukturat egzistuese rregullimin e ri ligjor për transparencën?

Kodi Zgjedhor me nenet respektive po zbatohet për herë të parë. Mbetet për t'u parë dhe për të provuar nëse do të jetë e nevojshme të plotësohet kuadri ligjor në këtë drejtim.

A keni vendosur deri tani marrëdhënie bashkëpunimi me subjektet politike zgjedhore në zbatim të detyrimit ligjor për transparencë ? Nëse po, si funksionon ky bashkëpunim dhe kur është vendosur ai? Nëse jo, ka ndodhur për mungesë angazhimi? Të cilës palë? Apo shihet e panevojshme?

Pa përgjigje.

A jeni njoftuar nga subjektet zgjedhore për hapjen e një numri të posaçëm llogarie pranë bankave për grumbullimin e donacioneve mbi 100 mijë lekë sipas kërkesave të Kodit Zgjedhor?

Deri në këtë moment subjektet politike pjesëmarrëse në fushatë nuk kanë depozituar këto llogari bankare pranë KQZ-së.

Nëse subjektet zgjedhore nuk e respektojnë këtë detyrim ligjor, brenda afateve që vendos ligji si do të procedoni?

KQZ do t'ju drejtojë një apel publik subjekteve që marrin pjesë në zgjedhje të përmbushin edhe këtë detyrim që përcakton ligji. Kodi Zgjedhor nuk parashikon marrje masash në rast vonesash lidhur me këtë çështje.

Neni 90 i Kodit Zgjedhor përcakton detyrimin e çdo subjekti zgjedhor për të regjistruar në një regjistër të posaçëm, miratuar si model me vendim të KQZ-së, shumën e fondeve të përfituara për çdo person fizik ose juridik, si dhe të dhëna të tjera që lidhen me identifikimin qartë të dhuruesit. A e keni miratuar ju këtë regjistër?

Pa përgjigje.

Në dijeninë tuaj a i zotërojnë subjektet zgjedhore potencialet e nevojshme në burime njerëzore dhe infrastrukturë për të respektuar detyrimin e transparencës së financimeve?

Nuk ka asnjë pretendim nga ana e subjekteve politike, për pamundësinë e zbatimit të këtij kuadri ligjor.

3- Vlerësimi i KQZ-së për zbatueshmërinë e ligjit të ri të transparencës.

Në gjykimin tuaj a është i mundshëm implementimi i ligjit të ri për transparencën financiare, duke marrë në konsideratë mjedisin ligjor përkatës dhe praktikën e deritashme të subjekteve zgjedhore?

KQZ është një institucion ekzekutues, i cili nga momenti i hyrjes në fuqi të një kuadri ligjor, ka vetëm një alternativë: zbatimin e tij.

Sipas gjykimit tuaj a është i realizueshëm detyrimi ligjor për transparencë në tërësinë e subjekteve zgjedhore? Nëse jo, për mungesë vullneti të subjekteve apo mangësi të instrumentave ligjorë?

Pa përgjigje.

Në gjykimin tuaj a ekziston infrastruktura e nevojshme për zbatimin e ligjit të transparencës së financimeve të subjekteve zgjedhore? Nëse jo, a do të përgatisë Institucioni juaj sugjerimet përkatëse dhe ku do t'i adresojë ato?

Derisa Kodi Zgjedhor është miratuar në Kuvendin e Shqipërisë, ligjvënësit nuk mund të hartonin një kuadër ligjor të pazbatueshëm.

Në gjykimin tuaj sa e rëndësishme është bërja e transparencës? Është më e rëndësishme për vetë subjektin, për elektoratin apo për institucionet? Nëse jo, pse?

Transparenca është e rëndësishme për vetë faktin pasi përbën një standard drejt së ardhmes europiane të Shqipërisë. Si e tillë ajo është e rëndësishme për të gjithë.

4. Vlerësimi i praktikës së deritanishme.

Çfarë rregullash ka ndjekur KQZ-ja deri tani për të përmbushur detyrimin e transparencës financiare të subjekteve politike? Nëse nuk është bërë ka ndodhur për mungesë të detyrimit ligjor, për zgjedhje të vetë subjektit, apo për mungesë të penalizimit ligjor?

KQZ ka zbatuar me përpikmëri kuadrin ligjor në fuqi lidhur me këtë aspekt.

Si e gjykoni performancën e deritashme të subjekteve politike në

këtë drejtim? A zbatojnë subjektet politike praktika të mira të menaxhimit financiar?

Pa përgjigje.

Sipas jush niveli i transparencës së financimeve të subjekteve politike deri më tani është përcaktuar nga kuadri ligjor apo kultura politike në vend?

Kuadri ligjor.

Sipas nenit 87 të Kodit Zgjedhor, shpenzimi total që mund të kryejë një parti politike, përfshirë edhe kandidatët e tyre, për një fushatë zgjedhore nuk duhet të kalojë 10-fishin e shumës më të madhe që një subjekt zgjedhor ka marrë nga fondet publike. A e gjeni realiste këtë shifër?

Është kompetencë e ligjvënësit të përcaktojë këto lloj detyrimesh.

ANEX 2

Pyetësor drejtuar dy subjekteve kryesore politike në vend: Partisë Demokratike dhe Partisë Socialiste. Partia Demokratike nuk ka bashkëpunuar në plotësimin e këtij pyetësori.

Subjekti politik: Partia Socialiste e Shqipërisë

Çështje për hulumtim

1- Ligje, akte nënligjore apo rregullore që përcaktojnë detyrimet ligjore të subjekteve zgjedhore në lidhjet me financimet që ato marrin (publike dhe jopublike)

Cilat janë ligjet apo aktet nënligjore që rregullojnë ligjshmërinë e financimeve të partive politike, te cilave ju i referoheni?

Ligji për Partitë Politike dhe ligji Nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”.

Sa jeni në dijeni ju si subjekt zgjedhor të këtyre përcaktimeve ligjore? Nëse po, sa i gjeni të qarta dhe të zbatueshme? A i njihni penalizimet për shkeljen e ligjit?

Jemi në dijeni të këtyre përcaktimeve ligjore.

Janë të qarta.

Po, i njohim.

E vlerësoni të mjaftueshëm detyrimin për transparencë vetëm gjatë periudhës zgjedhore apo e gjykoni të nevojshëm në mënyrë permanente? Pse?

Jam i mendimit që transparencja duhet të jetë vetëm për periudhën zgjedhore.

2- Mekanizmat funksionalë brenda subjekteve ligjore për zbatimin e ligjit të transparencës.

A ekzistojnë struktura funksionale pranë subjektit tuaj që mundësojnë rregullimin financiar të tyre? Nëse po, cilat janë ato? A ka një departament të financës?

Tek subjekti ynë zgjedhor ekziston struktura financiare që rregullon këtë proces. Kryefinacieri është i zgjedhur nga kryesia e partisë që drejton dhe organizon procesin financiar dhe bën transparencën pranë KQZ dhe organeve kushtetuese. Ka një strukturë me financierë dhe llogaritar, arkëtar.

A sjell nevojën për ngritjen e strukturave të reja të posaçme Kodi i ri Zgjedhor dhe detyrimet që burojnë prej tij? Nëse po, cilat janë? Nëse jo, a e përballojnë strukturat ekzistuese rregullimin e ri ligjor për transparencën?

Po, e përballon struktura aktuale.

A keni vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me subjekte të tjera në zbatim të detyrimit ligjor për transparencë (KQZ ose të tjera)? Nëse po, si funksionon ky bashkëpunim dhe kur është vendosur ai? Nëse jo, ka ndodhur për mungesë angazhimi? Të cilës palë? Apo shihet e

panevojshme?

Pa përgjigje.

A ka hapur subjekti juaj një numër të posaçëm llogarie pranë bankave për grumbullimin e donacioneve mbi 100 mijë lekë sipas kërkesave të Kodit Zgjedhor?

Po, jane hapur numra llogarie në 3 banka të nivelit të dytë që janë bërë publike për donacione në kohë fushate. Eshtë hapur në faqen e web-it të ps.al dhuro.ps.al. që bën të mundur edhe dhurimin on-line.

Sa jeni të gatshëm ju si subjekt zgjedhor të përshtasni/ krijoni, struktura të reja për transparencën? Nëse po, kur pritet të ndodhë kjo? Nëse jo, për mungesë kapacitetesh, apo nga mospërcaktimi i një afati?

Eshtë përgatitur një udhëzim për mënyrën dhe administrimin e fondeve për fushatën e zgjedhjeve, ku janë të përcaktuara mënyra e mbledhjes së fondeve dhe administrimi i tyre.

Në gjykimin tuaj a i zotëroni potencialet e nevojshme në burime njerëzore dhe infrastrukturë për të respektuar detyrimin e transparencës së fiancimeve? Nëse po, çfarë kostosh prodhojnë ato për subjektin? Nëse jo, si do të veproni?

Pa përgjigje.

3- Vlerësimi i vetë subjekteve për zbatueshmërinë e ligjit të ri të transparencës.

Në gjykimin tuaj a është i mundshëm implementimi i ligjit të ri brenda strukturës së subjektit zgjedhor përkatës? Nëse jo, për arsye të brendshme apo për mangësi të situatës ligjore?

Pa përgjigje.

Sipas gjykimit tuaj a është i realizueshëm detyrimi ligjor për transparencë në tërësinë e subjekteve zgjedhore? Nëse jo, për mungesë vullneti të subjekteve apo mangësi të ligjit?

Po.

Në gjykimin tuaj a egziston infrastruktura e nevojshme (ligjore dhe strukturore) për zbatimin e ligjit të transparencës së financimeve të subjekteve zgjedhore? Nëse jo, a do të përgatisë subjekti juaj sugjerimet përkatëse dhe kudo t'i adresojë ato?

Po.

Në gjykimin tuaj sa e rëndësishme është bërja e transparencës? Është më e rëndësishme për vetë subjektin, për elektoratin apo për institucionet? Nëse jo pse?

Është shumë e rëndësishme për vetë subjektin, elektoratin dhe institucionet ndërkombëtare që monitorojnë procesin.

4- Vlerësimi i praktikës së deritanishme.

Çfarë rregullash keni ndjekur deri tani për të përmbushur detyrimin e transparencës financiare të subjekteve politike? Nëse nuk është bërë ka ndodhur për mungesë të detyrimit ligjor, për zgjedhje të vetë subjektit, apo për mungesë të penalizimit ligjor?

Pa përgjigje.

A publikon subjekti juaj raporte vjetore për përdorimin e fondeve?

Po, subjekti zgjedhor dorëzon brenda afateve që përcakton ligji raport vjetor.

A janë këto raporte të certifikuara nga trupa profesioniste të miratuara me ligj?

Pa përgjigje.

A përdor subjekti juaj një sistem financiar të njohur për mbajtjen e kontabilitetit?

Po.

A prodhon subjekti juaj pasqyra financiare sipas standarteve kombëtare të kontabilitetit?

Po. Në bazë të ligjit subjekti zgjedhor dorëzon çdo fund viti ekonomik raporte financiare pranë DPT. (sipas legjislacionit tatimor në fuqi).

Po. Në fund të vitit subjekti ynë zgjedhor dorëzon pasqyra financiare të certifikuara nga ekspert kontabël të miratuar.

A ka subjekti juaj një libër politikash dhe procedurash të kontabilitetit dhe menaxhimit financiar të burimeve?

Pa përgjigje.

A auditohet nga auditorë të pavarur menaxhimi kontabël dhe financiar i subjektit tuaj? Nëse po, janë vendas apo të huaj?

Në bazë të ligjit Nr.10019 dt 29.12.2008, neni 91, KQZ përzgjedh një grup të ekspertëve kontabël për të audituar fonde të përfituara dhe të shpenzuara në kohë fushate. E përcakton KQZ me konkurim këtë procedurë.

Përshkruani procedurën e zakonshme të kontabilizimit të një donacioni nën 100 mijë lekë?

Sipas ligjit Nr. 10019, dt 29.12.2008, neni 90.

Përshkruani procedurën e zakonshme të blerjeve/pagesave për aktivitetet e subjektit tuaj.

Procedura e blerjeve dhe pagesave bëhet sipas legjislacionit tatimor në fuqi.

A bëni ju një raport të përmuajshëm me pasqyrën e donacioneve? Nëse po, a e paraqisni në ndonjë institucion financiar?

Pa përgjigje.

A është i ndarë funksioni i arkëtarit nga funksioni i kontabilistit të bankave (lëvizjes së fondeve në bankë) në departamentin tuaj të financës?

Eshtë i ndarë dhe në nivel pozicioni edhe në nivel page.

Si e gjykoni performancën e deritashme të subjekteve politike në këtë drejtim? A zbatojnë subjektet politike praktika të mira të menaxhimit financiar të organizatave jofitimprurëse?

Pa përgjigje.

Sipas jush niveli i transparencës së financimeve të subjekteve politike deri më tani është përcaktuar nga kuadri ligjor apo kultura politike në

vend?

Pa përgjigje.

A parashikon statuti juaj një raport vjetor për të informuar anëtarësinë? A botoni ju një raport të kësaj natyre? A keni kërkesa nga anëtarësia (dhe referenca për përgjigjen) për publikimin e raporteve të ngjashme?

Pa përgjigje.

A keni tregues për raportet e financimit të subjektit tuaj sipas kategorive dhurues korporative/dhurues individualë ose familjarë?

Pa përgjigje.

Sipas nenit 87 të Kodit Zgjedhor, shpenzimi total që mund të kryejë një parti politike, përfshirë edhe kandidatët e tyre, për një fushatë zgjedhore nuk duhet kalojë 10-fishin e shumës më të madhe që një subjekt zgjedhor ka marrë nga fondet publike. A e gjeni realiste këtë shifër?

Eshtë reale.

